



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar më: Priljeno:	12.09 20 24	
Njesia Jednica:	Numri Brez:	Shtojca Dodatak
15-052/01-45720		

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

DATE	12.09.2024
NGA	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
PËR	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Lipjanit
LËNDA	Raporti Janar – Qershor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale



I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal z. Daut Azemi

Me anë të kësaj shkrese po ua dërgoj raportin Janar – Qershor 2024 të punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Ky raport për periudhën e lartëcekur, paraqet punën dhe aktivitete e realizuara dhe është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale për raportimin e Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Prilijeno:	29.07 20 24	
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01-36454		



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN



R A P O R T
I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE
DREJTORATEVE KOMUNALE
JANAR – QERSHOR
2024

Korrik, 2024

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit.....	3
Përmbledhje Ekzekutive.....	5

ZYRA E KRYETARIT

1. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore	5
2. Zyra e Avokaturës Publike Komunale.....	6
3. Sektori për Marrëdhënie me Publikun	7
4. Njësia për Audi tim të brendshëm	9
5. Sektori i Personelit	10
6. Sektori pronësor – juridik	12
7. Zyra Lokale për Komunitete	13

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	14
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	18
3. Drejtorati për Arsim	26
4. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	31
5. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	35
6. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	40
7. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	41
8. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.....	45
9. Drejtorati për Infrastrukturë	46
10. Drejtorati për Inspeksion.....	48
11. Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	50
12. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	53
13. Drejtorati i Prokurimit.....	56

FJALA HYRËSE E KRYETARIT

Të dashur qytetarë të Komunës së Lipjanit,
I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar këshilltarë, media dhe ju të pranishëm,

Para jush po prezantoj raportin gjashtëmujor të parë të vitit 2024 të punës së Ekzekutivit të Komunës sonë. Referuar të dhënave buxhetore dhe objektivave të aprovuar, treguesit e këtij gjashtëmujori janë inkurajues dhe premtues, që dëshmojnë një punë sistematike, efektive dhe të suksesshme të ekzekutivit.

Të hyrat e përgjithshme vetanake deri në fund të muajit qershor kanë arritur të realizohen mbi 58.09%, me theks të veçantë tek të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë, të cilat deri më tani janë realizuar në 43.56% të planifikimit për vitin 2024. Një dinamike pozitive ka pasur edhe në shpenzimin e buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, ku për këtë periudhë raportuese janë shpenzuar 46.37% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimi në total për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 është 47.84%.

Në fushën e arsimit, gjatë kësaj periudhe raportuese është funksionalizuar çerdhja në fshatin Rufc të Ri, është përfunduar ndërtimi i shkollës së re në Ribar të Madhë, si dhe kanë filluar renovimet e shkollave në Rufc të Ri, Sillovi, Topliqan, Shalë, Bujan, Medvec, etj.

Me qëllim të ndërlidhjes së ekonomisë me arsimin profesional, ka filluar mësimin dual, i cili është realizuar nga shkolla e mesme profesionale "Adem Gllavica" në drejtimin automekanik. Ky proces do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm në zgjerimin e drejtimeve që praktikojnë mësimin dual, si drejtimi i tregtisë me shumicë e pakicë, etj.

Në shëndetësi, ngritja e performancës në Komunën e Lipjanit dhe rangimi në vendin e dytë në Kosovë, sipas matjeve të bëra dhe të publikuara së fundmi nga institucionet kredibile vendore dhe ndërkombëtare, si dhe riorganizimi i punës në institucionet shëndetësore ka ndikuar në rritjen e motivit të personelit shëndetësor për avancimin e mëtejshëm të shërbimeve cilësore shëndetësore.

Renovimi dhe rifunksionalizimi i QMF-së në Gadime dhe QMF-së në Janjevë janë shndërruar në modele jo vetëm në nivel vendi. Këto dy Qendra të Mjekësisë Familjare ofrojnë kushte me standardet më të larta për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Jemi ndër komunat e pakta që ofrojmë 43 teste/analiza laboratorike, duke përfshirë analizat HbA1c (Hemoglobina e Glikogjenizuar), AST, ALT dhe ASTO. Në shërbimin e laboratorit dhe në shërbimin e rëntgenit kemi evituar tërësisht pritjet e gjata për të marrë shërbimin shëndetësor. Kjo periudhë raportuese ka qenë e suksesshme në realizimin e planit të vaksinimit, si dhe në vaksinimin e vajzave të klasave të gjashta kundër virusit Human Papiloma (HPV). Komuna e Lipjanit është ndër top komunat me përqindjen më të lartë të realizimit të imunizimit.

Në fushën e planifikimit hapësinor, veçojmë zbatueshmërinë e HZ-së në bazë vjetore në nivelin 60%. Në periudhën janar-qershor janë pranuar 535 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 469. Të hyrat e planifikuara për vitin 2024 janë 221,500.00 euro, ndërsa vetëm në këtë gjashtëmujorë raportues nga DPU janë 381,727.56 euro.

Jam i kënaqur me dinamikën e investimeve kapitale, e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit. Aktualisht janë duke u zhvilluar në terren rreth 47 projekte investimesh nga komuna dhe projekte të tjera së bashku me partnerë. Gjithashtu, projekte të shumta kapitale janë në proces të publikimit, vlerësimit dhe lidhjes së kontratave, dhe shumë shpejt do të fillojë implementimi i tyre.

Shërbimet administrative në ambiente të reja të punës kanë mundur shërbime transparente dhe efektive duke avancuar dixhitalizimin e shërbimeve.

Shërbimet katastrale në këtë periudhë, kanë shënuar progres dhe është nënshkruar marrëveshja me Agjencinë Kadastrale të Kosovës për realizimin e projektit të rindërtimit të katër zonave kadastrale: Ribar të Madhe, Kraishtë,

Janjevë dhe Gadime e Epërme. Në këtë gjashtëmuor ka pasur rritje të numrit të kërkesave për regjistrimin e pronësisë në emër të dy bashkëshortëve dhe të grave.

Në Departamentin e Prokurimit, planifikimi vjetor në këtë periudhë raportuese është realizuar mbi 60%, duke shtuar efikasitetin dhe transparencën. Nuk është zhvilluar asnjë ankesë në OSHP.

Nga Departamenti për Ekonomi, promovimi i ambientit për të bërë biznes dhe zhvillimi i procedurave për investitorë do të reflektojë në gjenerimin e vendeve të reja të punës. Tashmë jemi në fazën e vendosjes së disa bizneseve në Zonat Ekonomike. Hartimi i master planit për zhvillimin e turizmit në Kodrën e Goleshit pritet të përfundojë këtë vit.

Kemi vazhduar subvencionimin me sera dhe mekanizma bujqësorë për ekonomitë familjare, në bashkëpunim edhe me donatorë dhe partnerë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Janë mbështetur fermerët prodhues të qumështit. Gjithsej në këtë gjashtëmuor janë subvencionuar mbi 600 fermerë lipjanas.

Në fushën e kulturës, gjatë periudhës janar-qershor 2024, kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme, siç janë: organizimi i eventeve lokale (tradicionale) për datat e rëndësishme shtetërore dhe të qytetit të Lipjanit, siç janë aktivitetet për Ditën e Pavarësisë, aktivitetet për Ditën e Dëshmorëve të Lipjanit, shënimi i ditëve përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve në komunën tonë, aktivitetet për 1 Qershorin, etj. DRKS ka subvencionuar klubet sportive dhe turniret e ndryshme sportive, si dhe aktivitete të tjera në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Gjithashtu, kemi mbështetur edhe OJQ-të që veprojnë në Lipjan dhe aktivitete të librit të autorëve lipjanas.

Inspektorati i Komunës ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme të inspektimit të deklaracionit të çmimeve të produkteve, kalibrimit të peshoreve, hedhjes së mbeturinave në vende jo adekuate, mbikëqyrjes së zbatimit të linjave të trafikut, të taksive, etj.

Kujdesi ndaj hapësirave publike ka vazhduar në mirëmbajtjen e hapësirave publike, mirëmbajtjen e rrugëve, mirëmbajtjen e lumenjve, mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes, si dhe mirëmbajtjen e shtatoreve, lapidarëve dhe varrezave.

Edhe këtë vit, Komuna e Lipjanit ka marrë opinionin më të mirë të mundshëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe është viti i nëntë me radhë që Lipjani merr vlerësimin më të mirë të mundshëm në auditim. Kur jemi te vlerësimet, i gëzohemi faktit që Komuna e Lipjanit në çdo matje që i bëhet komunave është në krye të listave në nivel vendi.

Kjo periudhë kohore, ky gjashtëmuor ishte i suksesshëm për komunën, por ka pas edhe sfida të natyrave të ndryshme gjatë implementimit të programit tonë.

I nderuar kryesues,
Të nderuar këshilltar komunal dhe
Ju të dashur qytetarë,

Në aktivitetet tona të përgjithshme e pa dallim, objektiv e përhershme mbetet qeversija e ligjshme, transparente dhe llogaridhënëse
Qyteti ynë, pavarësisht sfidave po rritet, Komuna jonë mbetet komuna me progres të jashtëzakonshëm, Lipjani mbetet konkurent i fortë në zhvillimin e përgjithshëm shoqërorë.

Do të vazhdoj të angazhohem fort e me përgjegjësi të zhvillojmë vendin tonë, komunën tonë. Mbeshteja juaj është determinuese e sukseseve tona.

Imri Ahmeti

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë raport gjashtë mujor për vitin 2024 paraqitet puna dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Raporti është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Edhe në këtë periudhë Janar-Qershor 2024, angazhim kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe dicitelipes në punë. Në këto gjashtë muaj kemi vazhduar të punojmë me përkushtim për të avancuar qëllimet e zhvillimit në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Në vazhdim po e paraqesim raportin që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtorateve dhe zyrave në kuadër të komunës.

ZYRA E KRYETARIT

SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore ka vazhduar me përcjelljen e zakonshme të Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve tjera nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës si dhe harmonizimin e akteve të Komunës me dispozitat e reja ligjore.

Kemi vazhduar me këshilla juridike dhe kemi ndihmuar Drejtoratet dhe sektorët e tjerë të komunës edhe në përplimin e akteve apo rregullimin e pjesës hyrëse- bazës ligjore sipas kërkesave të tyre si dhe kemi dhënë opinione të ndryshme rreth nënshkrimit të Memorandumeve apo Marrëveshjeve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

Me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform legjislacionit në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

Për lëndët e adresuara Kryetarit të Komunës nga kompetenca e Drejtorateve dhe e Zyrës së Kryetarit është udhëzuar nëpunësi për dorëzimin e shkresave që lëndët ti dërgojë në Drejtoratet përkatëse ndërsa lëndët e Zyrës së Kryetarit te përpunuesit sipas kompetencës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës janar-qershor 2024, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore me kërkesë të Kryetarit ka përgatitur Vendime, Urdhëresa, Shkresa të ndryshme, Marrëveshje, Kontrata, Propozim Rregullorë dhe Propozim Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës të cilat i kemi specifikuar në tabelën në vijim:

STATISTIKAT

1. Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për periodën janar-qershor 2024:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	227 vendime gjithsej 62 vendime me karakter individual jo të përgjithshëm ndërsa 165 vendime me karakter të përgjithshëm
2.	Shkresat	144
3.	Urdhëresa	1

4.	Kontrata	/
5.	Marrëveshje	274
6.	Propozim Rregullorë dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës	22

TAKIME TË NDRYSHME

Sekori për përfaqësim dhe çështje ligjore ka marrë pjesë në takime pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

ZYRA E AVOKATURËS PUBLIKE KOMUNALE

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit:

Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve Zyra e Avokaturës Publike Komunale, brenda afatit të kërkuar bën këtë raport të punës me sa vijon;

Nga viti 2023 janë bartur për këtë vit gjithsej 1925 (civile, përmbartimore, penale dhe administrative) lëndë që janë ende në punë.

Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve brenda afatit të kërkuar bën këtë raport të punës me sa vijon;

Lëndët	Nr.
Lëndë të pranuar civile	400
Lëndë të pranuar përmbartimore	197
Lëndë në procedurë administrative brenda institucionit	8
Seanca të mbajtura	334
Ankesa të ushtruara në Gjykatën e Apelit (civile dhe përmbartimore)	263
Përgjigje në Padi të ushtruara	400
Prapësime në procedurë përmbartimi	6
Propozime për përmbartim	1
Padi të ushtruara	4
Lëndë të arkivuara civile	133
Lëndë të arkivuara përmbartimore	13

Përshkrimi i natyrës së lëndëve të pranuar

Nga 400 lëndë (padi dhe propozime) të pranuar;

- 378 kanë të bëjnë me lëndët e arsimit, pra kërkesa që dalin nga kontrata kolektive siç janë: paga jubilarë, paga përcjellëse, ushqim, udhëtim, inflacion, kualifikim dhe orë me klasë të kombinuara si dhe tani padi të reja për orët mbi normën e paraparë dhe orë të mbajtura gjatë fundjavës për shkak të grevës të sektorit të arsimit.

- 2 kanë të bëjnë me kompensime të dëmit për shkak se pretendohet që është prekur prona private gjatë punimeve të ndërtimit të infrastrukturës lokale.

-2 kanë të bëjnë me vërtetimin e pronësisë.

-1 padi për kompensimin e pagës së 13-të nga sektori i shëndetësisë.

- 4 propozime për anulimin e shpronësimit të pronës private për projektet e Komunës siç janë Parku i Qytetit dhe parkingu nëntokësor si dhe rregullimi i trasesë në rr. "Bashkim Krasniqi".

- 1 që ka kundërshtuar në tërësi shpronësimin për projektin e Komunës "Parku i Qytetit dhe parkingu nëntokësor".

- 4 padi për anulimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, ku Komuna paraqitet si e paditura e dytë.

Komuna ka paraqitur 4 padi, nga këto;

- 2 për bartjen e mjeteve nga kompanitë e sigurimit (siguracion të tenderit),
- 1 kompensim dëmi të shkaktuar me rastin e ndarjes me koncesion të banesave dhe lokaleve afariste dhe
- 1 anulim vendimi të shpronësimit në afërsi të Z.E. "Kërçeva".

Përmbledhje për disa lëndë të vlerës së madhe

Gjatë periudhës raportuese, veçojmë disa lëndë të cilat janë gjykuar në favor të Komunës dhe që kanë vlerë të konsiderueshme financiare, e ato janë:

- P.nr. 317/22, shuma e kontestit 655'743.59 € (pala ka parashtuar ankesë).
- C.nr. 1042/20, shuma e kontestit 12'000.00 € (pala ka parashtuar ankesë).
- C.nr. 313/16, vërtetim pronësie (kthyer në ri-gjykim).
- C.nr. 61/03, shuma e kontestit 13'188.00 € (vërtetuar nga Gjykata Supreme).
- C.nr. 134/05, shuma e kontestit 15'907.23 € (pala ka parashtuar ankesë).
- A.nr. 634/16, për pagesën e tatimit në pronë në shumen prej 63'637.38 €.
- C.nr. 163/15, shuma e kontestit 22'000.00 € (vërtetuar nga Gjykata e Apelit).
- C.nr. 854/20, për vlerën e kontestit 34'286.16 € (vërtetuar nga Gjykata e Apelit).

Sfidat

Gjatë periudhave raportuese të kaluara por edhe kësaj periudhe, kanë qenë sfida kryesore që edhe kanë paraqitur problem gjatë mbrojtjes ligjore të interesave të Komunës, mungesa e dokumentacioneve nga arkiva dhe mangësia, vështirësitë për gjetjen e dokumenteve arkivore të viteve të paraluftës.

Gjithashtu sfida tjetër ende mbetën Kontratat kolektive të arsimit dhe shëndetësisë në të cilat Komuna nuk është fare nënshkruese e tyre por janë ministritë e përkatëse, të cilat nuk kanë menduar fare për gjetjen e mënyrës së ekzekutimit të obligimeve që rrjedhin nga këto kontratë në procedurë administrative në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i komunave në procedurë gjyqësore dhe të krijohen shpenzime të pa nevojshme.

Rekomandime

Në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës – Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të gjendet zgjidhje për kërkesat që dalin nga Kontratat Kolektive Sektoriale e po ashtu të definohet statusi i zjarrfikësve për shkak të dualitetit dhe përzierjes së kompetencave mes të AME-së – MPB-së dhe Komunës.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Raporti gjashtëmuor i Sektorit për Marrëdhënie me Publikun për periudhën janar-qershor 2024 përmbledh një gamë të gjerë aktivitetesh dhe arritjesh të rëndësishme. Komuna e Lipjanit ka demonstruar një përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj transparencës dhe informimit publik, duke siguruar që qytetarët të kenë akses të plotë në informacionet dhe aktivitetet e komunës. Një nga arritjet që padyshim mund ta veçojmë është vendi i parë që Komuna e Lipjanit ka arritur në raportin e publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), për vlerësimin e bërë sipas Transparometrit Komunal, për nivelin e transparencës së 38 komunave të Republikës së Kosovës për vitin 2023. Ky rezultat i shkëlqyer reflekton përpjekjet e vazhdueshme për të promovuar transparencën dhe llogaridhënien.

Gjithashtu, në pjesën e raportit të performancës komunale, Komuna e Lipjanit ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm duke marrë 100% të pikëve në transparencë. Ky rezultat tregon përkushtimin e fortë të komunës për të qenë një model në ofrimin e shërbimeve publike dhe në komunikimin efektiv me qytetarët e saj.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periudhës raportuese, Sektori për Marrëdhënie me Publikun ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

-Janë përcjellur aktivitetet e Kryetarit të Komunës, ekzekutivit, Kuvendit dhe Komiteteve brenda dhe jashtë komunës dhe janë përgatitur lajme për publikim në faqen zyrtare, rrjetet sociale dhe media të tjera.

-Sipas kërkesave të Drejtorateve dhe sektorëve tjerë, janë publikuar në faqen zyrtare materialet e ofruara për zyrën e informimit.

-Janë publikuar të gjitha vendimet e Kryetarit për periudhën janar - qershor me karakter të përgjithshëm, raportet e drejtorëve, vendimet e kuvendit, njoftimet dhe konkurset e shumta që janë dërguar në zyrën për informim.

-Janë publikuar kontratat e prokurimit të dërguara për publikim nga Drejtorati i Prokurimit.

-Janë ofruar informacione për gazetarë duke iu referuar kërkesave të tyre dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

-Gjatë periudhës raportuese, janë realizuar konsultime publike të akteve komunale, duke organizuar debate publike për këto akte me qëllim të përfshirjes së qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin vendimmarrës. Pas zhvillimit të debateve publike, janë përgatitur procesverbale dhe raportet përkatëse, të cilat dokumentojnë diskutimet dhe konkluzionet e arritura. Këto dokumente janë publikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie për të gjitha vendimet e marra.

-I është kushtuar rëndësi e veçantë përditësimit të faqes zyrtare të komunës me informacione të rëndësishme për qytetarët, përfshirë publikimin e konkurseve, thirrjeve për grante, thirrjeve për subvencionim dhe dokumente të tjera, pavarësisht vështirësive teknike që ka pasur faqja.

-Materialet e ndryshme të drejtuara zyrës për komunikim me publikun janë publikuar edhe në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në platformën e konsultimeve publike të qeverisë së Kosovës.

-Është bërë azhurnimi dhe mirëmbajtja e panelëve në tri hyrjet kryesore të qytetit të Lipjanit.

-Gjatë periudhës janar-qershor, është menaxhuar kontrata lidhur me shërbimet mediale në komunën e Lipjanit.

STATISTIKAT

Sektori për Marrëdhënie me Publikun në periudhën e gjashtëmujorit të parë 2023 ka publikuar në web faqe:

Lajme	Raporte të konsultimeve publike + procesverbale	Njoftime	Konkurse	Materiale të kuvendi dhe trupave të tij	Kërkesë / qasje në dokumente publike	Ftesa	Raportet e drejtorateve	Përcjellja e aktiviteteve të komunës në teren	Materiale të prokurimit	Vendimet e kryetarit	Thirrje për OJQ
147	8 raporte +8 procesverbale	91	17	6	20	18	78	73	50	69	4

Sektori për Marrëdhënie me Publikun në periudhën e gjashtëmujorit të parë 2023 ka publikuar në platformën e konsultimeve publike të qeverisë së Kosovës:

Plane	Statute	Njoftime për debat me qytetarë
5	1	7

NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Me aprovimin e ligjit mbi kontrollin dhe menaxhimin financiar me të cilin ishte ndryshuar koha e dorëzimit të planit vjetor të punës në Ministrinë e Financave pas aprovimit nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës, në Muajin Dhjetor 2023, është përpiluar Plani Strategjik trevjeçar për vitet 2024-2026 dhe është miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe është aprovuar nga Kryetari i Komunës siç parashihet me Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Me planin strategjik janë paraparë të gjitha fushat e Auditimit të cilat duhet të mbulohen me aktivitete Audituese nga NJAB për një cikël trevjeçar të Auditimit, duke i renditur sipas shkallës së Rrezikut për të çdo fushë si dhe duke i paraparë fushat me rrezik të lartë për çdo vit në fushëveprim të Auditimit

Pas vlerësimit të rreziqeve për çdo fushë të identifikuar, duke marrë parasysh gjasën e ndodhjes dhe ndikimin e rreziqeve për procesin për secilën fushë është bërë rangimi i detyrave të punës të cilat janë auditive të rregullta të planifikuara, për tri vitet 2024-2026, duke u bazuar në këtë renditje të entiteteve që do të auditohen, fushat e vlerësuara me rrezik të lartë sipas planit strategjik do të auditohen për çdo vit, fushat me rrezik të mesëm do të jenë në fushëveprim të Auditimit për çdo dy vite, ndërsa fushat e vlerësuara me rrezik të mesëm për çdo tri vite, pas renditjes së fushave të auditimit dhe harmonizimit të detyrave me kapacitet ekzistuese të auditimit të cilat i disponon NJAB, është përpiluar plani vjetor i punës për NJAB –në për vitin 2024.

Pra nga plani strategjik 2024-2026, është bazuar Plani vjetor i punës i NJAB-së për vitin 2024 me qëllim të planifikimit të Auditimeve efektive për vitin 2024.

Me Ligjin e Auditimit të Brendshëm nr 03/L-128, Komiteti i Auditimit është kompetentë për miratimin e planeve të Njesisë së auditimit të brendshëm dhe shqyrtimin e raporteve të punës së NJAB-së, ku luan rolin ndërmjetësues në mes të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe ZKA-as, ndërsa nga ZKA, këto plane aprovohen.

NJAB për vitin 2024 ka planifikuar 11 Auditime prej të cilave një auditim të performancës dhe 10 auditime tjera Auditime të përputhshmërisë dhe financiare dhe një Auditim të performances.

Pas raportimit të detyrave të kryera nga NJAB për vitin paraprak në fillim të vitit 2024 në Komitetin e Auditimit, NJQHAB-në dhe Zyrës së Kryetarit, NJAB në bazë të planifikimi vjetor ka filluar të kryej detyrat e planifikuara në përputhje me planin vjetor të punës për vitin 2024.

Angazhimi i NJAB në gjashtëmuorin e parë ka pasur për synim realizimin e auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2024 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera, pasi që drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi kanë përgatitur plane të veprimit për implementimin e rekomandimeve, ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim me të cilën ka njoftuar edhe ZKA-an, lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB. Puna që është kryer gjatë periudhës Janar -Qershor 2024, i referohet pikërisht përmbushjes së objektivave të parapara me këto plane të cekura më lartë.

Sa i përket detyrave të cilat janë planifikuara për vitin 2024, të gjitha janë auditime të bazuara nga plani i punës i aprovuar për vitin 2024 për NJAB-em

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- 1). Auditimi i Proceduarave të Prokurimit për periudhën 01.01.2023-31.12.2023
- 2). Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë për periudhën Shkurt 2023-Janar 2024, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
- 3). Auditimi në Drejtorinë e Administratës Komunale „Përdorimi dhe menaxhimi i veturave zyrtare në Administratën Komunale” periudha 01.02.2022 deri me 15.03.2024
- 4). Auditimi i të hyrave nga taksat për lejet ndërtimore në Drejtorinë për Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit periudha prej 01.04.2023 – 31.03.2024
- 5). Auditimi në Drejtorinë Shëndetësisë (QKMF)- Procedura e shpenzimeve për periudhën 01.04.2022 – 30.04.2024.
- 6). Auditimi i të hyrave të arkëtuara nga taksat në Zyrat e Vendit dhe ofiqari në Drejtorinë e Administratës për periudhën 01.08.2022 deri me 01.05.2024

Të gjitha Raportet Finale janë lëshuar pasi që Entitet ku është kryer auditimi kanë përgatitur planin për zbatimin të rekomandimeve nga përgjegjësit e drejtorive , ndërsa me raportin Final NJAB ka dorëzuar edhe formularin për rishikimin e progresit të rekomandimeve sipas afatit të cilin e kanë paraparë Entitetet e audituara .

Gjatë periudhës Janar –Qershor 2024, NJAB , përmes rishikimeve të auditiveve ka monitoruar edhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë me rastin e kryerjes së auditimeve të brendshme dhe për të cilat menaxhmenti (zyrtarët përgjegjës të entitete ku është kryer auditimi),ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-së

Në këtë periudhë janë kryer edhe pesë rishikime të auditimeve sipas orarit të paraparë për rishikim NJAB ka marrë pjesë edhe në përgatitjen e planit të zbatimit të rekomandimeve për rekomandimet e pranuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit ,si dhe ka kryer Rishikimin e progresit të zbatimit të rekomandimeve.

STATISTIKAT

Gjatë gjashtë mujorit të parë, nga NJAB janë finalizuar gjashtë (6) Auditime të rregullta të planifikuara janë përfunduar sipas planit vjetor të punës për vitin 2024.

Po ashtu janë kryer edhe gjashtë (6) Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informatave të shkruara përgjegjësve të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit (kryetarit të komunës) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve apo progresin e arritur .

Në mesin e rishikimeve të kryera ka qenë edhe rishikimi i planit të zbatimit të rekomandimeve të Zyrës kombëtare të Auditimit , rishikim i dytë cili është kryer para datës 15.03.2024, që i referohet një raportit nga viti paraprak për PVF 2022, pasi që raporti i auditorit të jashtëm për PVF për vitin 2023 ka ardhur në muajin qershor 2024.

Më datën 18.06.2024 pas pranimit të raportit final të Auditorit të Zyrës Kombëtare , NJAB ka punuar me grupin për trajtimin e rekomandimeve për përgatitjen e planit të zbatimit të rekomandimeve nga Raporti Final i ZKA-it për PVF për vitin 2023

Ky Plan është dorëzuar me kohë brenda 30 ditëve në ZKA –it dhe këto rekomandime pritet të zbatohen gjatë vitit 2024

TAKIME E NDRYSHME

Gjatë këtij gjashtë mujori janë mbajtur edhe dy takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar puna e NJAB-së për periudhat TM4-2023 , së bashku me Raportin Vjetor të punës së NJAB-së për vitin paraprak , takim është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2024.

Raporti për Tremujorin e parë 2024, (TM1-2024) , takimi është mbajtur në Muajin Prill 2024)

SEKTORI I PERSONELIT

PËRMBLEDHJA E PËRGHITHSHME E RAPORTIMIT

Në kuadër të fushë veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore kujdeset për të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë, në pajtim me dispozitat e ligjore në fuqi. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është angazhuar në kryerjen e punëve me përgjegjësi të plotë në hartimi e vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të saj. Në Administratën Komunal sipas Strukturës Organizative të Administratës Komunale kemi 231 pozita të planifikuara ku aktual kemi 204 zyrtar, prej tyre shërbyes civil meshkuj kemi 112, ndërsa femra 67, me aftësi të kufizuar i kem 3 prej tyre dy meshkuj, dhe një femër.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Njësi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka sistemuar formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të zyrtarëve duke i vendosur nëpër dosje fizike dhe elektronike. Siguron zbatimin e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë, pushimet, trajnimet, administron sistemin për vijueshmërinë në punë, procedurat disiplinore, procedurat e ankesave, mbështet dhe organizon punën e Komisionit Disiplinor për nëpunësit e shërbimit publikë dhe Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publikë, pezullimin e marrëdhënies së punës, transferimin e nëpunësve, përfundimin e

marrëdhënies së punës – lirim nga shërbimi civil, vërtetimet, statistikat e të punësuarve etj., në bazë të legjislacionit në fuqi;

STATISTIKAT

Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti përmbledhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raporti 6 mujor Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor 2024	6
2	Aktemrime	4
3	Aktemrime për Zyrtarët Komunal	82
4	Vlerësimi i rezultateve në punë për Zyrtarët e administratës komunale	141
5	Konfirmimi për disponueshmëri të mjeteve	1
6	Kompletimi i të dhënave të përvojës së punës për Zyrtarët e Administratës Komunale për Ministrin e Financave	156
	SHKRESAT PER ANTIKORRUPSION	
7	Njoftime për deklarim të pasurisë në APK	10
8	Njoftime për deklarim të dhuratave për zyrtarët publik të Komunës së Lipjanit dhe APK-ën	2
	LISTAT	
9	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	110
10	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	97
	PUSHIMET	
11	Pushime mjekësore.	61
12	Pushime vjetore.	163
13	Pushim i Atësisë	1
	FORMULARET PER NDRYSHIME	
14	Punimi i formularëve për ndryshime	37
15	Punimi i formularëve për punëtorët e larguar	9
16	Punimi i formularëve për punëtorë të rinj	7
17	Punimi i formularëve për transfer bankar	2
18	Punimi i formularëve për retroaktiv	10
	VERTETIMET	
19	Vërtetim për kryerjen e praktikës	10
20	Vërtetim për përvojë të punës	3
	VENDIMET	
21	Vendim për pushim ditore për nënat lehonë për mbrojtjen e të Ushqyerit të fëmijës	1
22	Vendim për ndërprerje e marrëdhënies së punës	6
23	Vendime për kryerjen e praktikës	6
24	Vendim për emërim	1
25	Vendim për Pushim të Lehonisë	1
26	Vendim për Transferime	5
27	Vendim për përvojë të punës	5
28	Vendime për Udhëtime Zyrtare	10
	KONKURSET	
29	Kërkesa për aprovim të konkurseve	9
30	Publikimi i konkurseve në Administratën Komunale	9
31	Publikimi i konkurseve për Arsim dhe Shëndetësi	3
32	Publikimi i konkursit për Praktikantë me pagesë	1
33	Vendim për Formimin e Komisionit Rekrutues	11
34	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve SIMBNJ	174
35	Njoftim për procedurat e rekrutimit, për test me shkrim dhe intervistë	47

36	Vendim për refuzimi të Aplikacioneve	69
37	Intervistë dhe testit me shkrim për procedurat e rekrutimit	19
	KERKESAT	
38	Kërkesë për Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/ DMZP (pagesa retroaktive)	2
39	Kërkesë për Komision Disiplinor	2
40	Kërkesa për ID- kartela zyrtare	5
	PERGJIGJET	
41	Përgjigje ne kërkesë për masë disiplinore	1
42	Përgjigjeje në Kërkesat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	2
43	Përgjigje në kërkesë	4
	NJOFTIM	
44	Njoftim për arritjen e moshës së pensionimit	2
45	Njoftim/ ftesë për komision disiplinor	2
46	Njoftim për përfundimin e periudhës provuese	4
47	Njoftim për drejtorët dhe shefat e sektorëve lidhur me pushimet dhe vijueshmërinë ne pune	1
48	Njoftime te ndryshme	5
	PËLQIME	
49	Pëlqim për Transferime	5
50	Pëlqim për nënshkrimin e Aktemrimit (për emërim)	4
	REGJISTRAT	
51	Regjistri i trajnimeve	56
52	Regjistri për vijueshmëri për ASHI	1
	AUDITORET	
53	Auditim nga Auditorët e jashtëm	1
	Gjithsejtë	1386

SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

Gjatë periodës raportuese është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

Gjatë tërë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhës RAPORTUESE

Gjatë periodës raportuese për 6 muhor Janar-Qeshor 2024, Sektori Pronësoro-Juridik ka përgatitur Vendime, shkresa të ndryshme, Pëlqime, Kontrata dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

STATISTIKAT

1. Aktet e përgatitura nga Sektori Pronësoro-Juridik për 6 muhor Janar-Qeshor 2024:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendime	10
2.	Shkresa	49
3.	Pëlqime	1
4.	Kontrata	21
5.	Propozim-Vendime	4

Sektori Pronësores-Juridik ka pranuar lëndë në procedurë administrative të natyrave të ndryshme si: nga Drejtorati i Administratës Komunale, Sektor të Drejtorateve dhe lëndë të parashtruara nga palët, gjithsej 97 lëndë nga nuaji Janar-Qershor, prej tyre të kryera 85 dhe në procedurë administrative 12 lëndë.

TAKIME TË NDRYSHME

Sektori Pronësores-Juridik ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

ZYRA LOKALE PËR KOMUNITE

Gjatë kësaj periudhe, ZKKK-ja, krahas aktiviteteve tjera të rregullta, ka punuar në zgjidhjen e problemit të familjeve të riatdhesuara, punën me organizatat jo qeveritare, zgjerimin e akomodimit të familjeve të riatdhesuara dhe ndihmën për krijimin e familjeve private.

Aktivitetet në të cilat ka punuar ZKKK gjatë kësaj periudhe:

Kemi pranuar 2 kërkesa për strehim të personave të riatdhesuar, lëndët i kemi përfunduar dhe i kemi dërguar për shqyrtim në Komisionin Komunal për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Komisioni ka miratuar 2 kërkesa për strehim. Janë përgatitur 2 vendime për akomodim dhe janë nënshkruar 2 kontrata për akomodimin e personave të riatdhesuar. Është nënshkruar kontrata për zgjatjen e akomodimit për një azilkërkues nga Turqia.

Të dhënat për personat e riatdhesuar janë futur në bazën e të dhënave të MPB-së

ZKKK ka paraqitur kërkesë në MPB për sigurimin e ushqimit dhe materialeve higjienike për një person të riatdhesuar.

IOM ka zgjedhur tri kompani që kishin vështirësi me funksionimin e tyre gjatë pandemisë COVID dhe u dha atyre ndihmë në pajisje shtesë me vlerë 1500 euro për kompani.

ZKKK –ja edhe gjatë kësaj periudhe ka ndihmuar palët për plotësimin e dokumentacionit për aplikime të ndryshme si dhe në konkursin për ndërtim shtëpie të shpallur nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Për këtë familje të kthyer kemi siguruar dhënie e lejes së ndërtimit për ndërtimin e një shtëpie. Kemi vizituar një familje nga Janjeva e cila paraprakisht ka paraqitur kërkesë për rinovim të shtëpisë me qëllim të përfundimit të pedmetit. Me Udhëheqjen e Divizionit për të drejtat e njeriut të MLS-së, vizituam një familje në Janjevë e cila u ankua për rrjedhën e ujit në shtëpi dhe dëmtimin e shtëpisë. Pas vizitës kemi mbajtur një takim të përbashkët me nënkryetarët e komunës.

Në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit, kemi vizituar një kompani me qëllim të vazhdimin të kontratës së punës për dy persona të riatdhesuar.

Në këtë periudh kohore po ashtu kemi vizituar tri familje të kthyer për të kontrolluar gjendjen e tyre ekonomike. Për një të kthyer, ne siguruam një dokument pronësie dhe një kopje të planit.

Me një oficer dhe një inxhinier nga IOM, kemi vizituar një familje të kthyer në Medvece, e cila ka nevojë për një shtëpi të ndërtuar, si dhe një paketë shtesë ndihme për të kthyerit, dhe po ashtu shtë regjistruar një familje e kthyer nga Serbia.

ZKKK gajt këtij gjashtë mujori ka marrë pjesë në punën e komisionit Advancing Together për përzgjedhjen e kompanisë për zbatimin e projektit të prishjes së ndërtesës së vjetër të administratës së minierës Golesh në Magure.

Në emër të komunitetit, ZKKK ka aplikuar në IOM për projektin infrastrukturor të rindërtimit dhe ndërtimit të ndriçimit rrugor në tre rrugë të Lagjes së Re.

Takime të ndryshme

Kemi pas takime GIZ-in gjerman, OSBE-në, MKK-në, FSK-në, IOM etj. Si dhe gjatë këtij gjashtë mujori kemi pasur trajnime me karaktere të ndryshme.

DREJTORATET KOMUNALE

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

Përmbledhja e raportimit të përgjithshme

Në periudhën 6 mujore të vitit 2024 janë realizuar të gjitha punët, detyrat dhe obligime në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, statutit të Komunës së Lipjanit, ligjet tjera, Udhëzimet, Urdhëresat, si dhe Rregulloret tjera Komunale.

Janë zhvilluar takime të rregullta, si dhe koordinimi i punëve me shefat e sektorëve, raporte të rregullta javore, mujore drejtuar Kryetarit të Komunës, takime në nivelin qendror në bazë të agjendave.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë këtij gjashtë mujori po i pasqyrojmë disa aktivitetet dhe progresin e ndodhur në dikastere të Administratës. Aktivitetet kryesore janë kryesisht në sektorin e Administratës së Përgjithshme, Gjendjes Civile, Punëve të Kuvendit dhe Komiteteve, si dhe Mirëmbajtjes dhe Operimit të organizatës. Përmbledhja e shkrimit paraqitet si më poshtë:

Në sektorin e administratës së përgjithshme në qendrën e shërbimeve për qytetarë, janë regjistruar dhe protokolluar kërkesat dhe parashtrirat nga qytetarët përmes intranetit komunal. Janë ofruar shërbimet postare, përgjigjet e shkresave, shërbimet e arkivave komunale dhe shërbimet e përgjithshme ndaj qytetarëve. Shërbimet janë kryer në mënyrë efektive për qytetarët që jetojnë në mërgim, duke ua lehtësuar qasjen në shërbimet e nevojshme.

Gjatë kësaj periudhe, janë mbajtur konsulta me qytetarët lidhur me përdorimin e platformës E-Kosova për kryerjen e disa shërbimeve, në platformën e gjendjes civile, shërbimet familjare si dhe në ato për subvencione duke përfshirë regjistrimin. Konsultat kanë ndihmuar në përmirësimin e qasjes dhe përdorimit të kësaj platforme nga qytetarët.

(<https://ekosova.rks-gov.net/Service/5> dhe <https://ekosova.rks-gov.net/Service/1>).

Janë zhvilluar konkurse nga Komuna e Lipjanit për Drejtorin e Shëndetësisë, Arsimit, Bujqësisë dhe për shërbimin civil të Komunës. Në këtë periudhë janë mbajtur takime për performancën komunale dhe janë grumbulluar të dhënat relevante për drejtoritë të ndryshme.

Shërbimet e sigurimit fizik në objektet komunale kanë vazhduar me gatishmëri të plotë, duke u koordinuar mirë dhe duke përmbushur detyrat sipas kontratës në fuqi.

Janë futur të dhënat në sistemin e prokurimit për transparencë. Kemi kryer detyrat përkatëse dhe kemi komunikuar me drejtorinë e thesarit dhe financave për koordinimin e raporteve dhe regjistrin e faturave.

Menaxhimi i materialit shpenzues për shërbimet në sektorin e administratës së përgjithshme është planifikuar dhe zbatuar në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe shpenzimet për letrën dhe fotokopjet për qytetarë.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit për udhëtim pa viza, kemi caktuar një zyrtarë që ta bëjë verifikimin dhe monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit pa viza. Zyrtari të cilin e kemi përzgjedhur ka dërguar raportin në mënyrë elektronike në ministrinë e pushtetit lokal.

Është hapur konkursi për praktikant për pesë muaj. Janë pranuar 34 praktikantë me drejtime të ndryshme të cilët i ka përzgjedhur komisioni i cili është caktuar për vlerësimin e tyre.

Përgjatë këtij gjashtë mujori administrata e Komunës së Lipjanit ka qenë aktive në organizimin dhe pjesëmarrjen e trajnimeve dhe aktivitete tjera, me synim përmirësimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të stafit. Ky raport përmbledh të gjitha trajnimet dhe aktivitetet relevante gjatë kësaj periudhe. Po ashtu stafi i administratës komunale ka

marrë pjesë në disa trajnime dhe aktivitete që kanë pasur për qëllim rritjen e performancës dhe efikasitetit të komunës. Në këto trajnime është përfshirë dhe: Menaxhimi i Performancës, ky trajnim ka fokusuar në zhvillimin e aftësive për të vendosur objektiva të qarta, matjen e rezultateve dhe përmirësimin e proceseve administrative.

Ka pasur një numër të madh të shërbimeve të gjendjes civile gjatë këtij gjashtëmujori, të realizuara në mënyrë efektive dhe me korrektësi. Procedurat e gjendjes civile vazhdojnë të zbatohen sipas udhëzimeve administrative.

Në sektorin për mirëmbajtje dhe operim kemi gjithsej 14 vetura në shërbim, ndërsa një veturë është jashtë përdorimit. Veturat që i kemi në shërbim janë të stërvjetruara dhe e kemi shumë të vështirë menagjimin e tyre për arsye se ka kosto të madhe për riparimin e tyre.

Si Departament i Administratës vazhdimisht kemi bërë kërkesë për blerjen e veturave por asnjëherë nuk është marrë parasysh kërkesa jonë nga OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit)

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore po paraqesim në mënyrë kronologjike disa aktivitete të rëndësishme gjatë këtij gjashtëmujori:

Tryezë pune e Grupit Punues për hartimin e planit të veprimit për barazi Gjinore për komunën e Lipjanit 2024-2026. Ky është mbështetur nga UN Women në Kosovë në kuadër të projektit "Gender Equality Facility" që po zbatohet në Kosovë.

Takim i grupit punues për hartimin e rregullores së brendshme të shkollave fillore "Luftimi i gjuhës së urrejtjes përmes rishikimit dhe hartimit të rregulloreve të shkollave fillore të komunës së Lipjanit.

Takimi i dytë punues i grupit për hartimin e Planit Komunal për Barazi Gjinore 2024-2026, me ç, rast u prezantua drafti i parë i këtij plani të cilin po e mbështete UN Women në Kosovë në kuadër të projektit "Gender Equality Facility" që po zbatohet në Kosovë.

Punëtori treditore lidhur me monitorimin dhe zbatimin e gjuhëve zyrtare në ndërmarrjet publike dhe administratës së komunës së Lipjanit.

Me 7 mars është organizuar debat publik me qytetare për komentet me rastin e hartimit të draft planit 2024-2026 për Planin komunal për barazi gjinore .

Debat me qytetar për hartimi e planit të këshillit komunal kundra dhunës në familje dhe në baza gjinore 2024-2026

Takim pune në komisionin për hartimin e planit Komunal 2024-2026 për zhvillimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Qendra e Trajnimeve e Asociacionit të Komunave (AAK) kemi mbajtur punëtori njëditore me zyrtarë për barazi gjinore me qëllim të identifikimit të Mekanizmave të Brendshëm Institucional për mbrojtje të dinjitetit ,barazisë gjinore dhe mos diskriminimin brenda komunave.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale ka organizua takim pune me përfaqësuesit e Institucioneve nga komuna e Lipjanit për informimin ,identifikimin ,referimin dhe fuqizimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Sesion informues për trashëgiminë në pronë në qytezën e Janjevës në ambientet e OJQ-së lokale "Ideas Partnership" në Janjevë në komunën e Lipjanit ,është mbajtur me gratë e komuniteteve të përziera punëtori informative mbi të drejtat pronësorë të grave .Këtë aktivitet e ka organizua zyra për Barazi Gjinore s'bashkua me OJQ-en "Ideas Partnership" e përkrahur nga OSBE-ja.

Dhe shumë aktivitete e punëtori të tjera për të cilat Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore ka realizuar në koordinim me Zyrën e Kryetarit dhe raportuar në baza javore e mujore.

Shërbimet edhe në formë tabelare - statistikore

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
•	protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në qendrën për shërbime me qytetarë	
1	kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	6876
2	kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	392
3	kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	16458
•	pranimi dhe dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	
4	aktvendime të shpërndara	318
5	ftesa të shpërndara	928
6	vendime të shpërndara	169
7	fletëparaqitje për gjykatë	64
8	njoftime të shpërndara	179
9	të arritura me postë	321
10	të dërguara me postë	1135
11	Fatura tatimore të Qirasë	85
12	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë 1859.8€	
	Gjithsej	26925

Spektori për Administratë të Përgjithshme

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
•	Protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	6876
2	Kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	392
3	Kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	16458
•	Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	
4	Aktvendime të Shpërndara	318
5	Ftesa të Shpërndara	928
6	Vendime të Shpërndara	169
7	Fletëparaqitje për Gjykatë	64
8	Njoftime të Shpërndara	179
9	Të Arritura me Postë	321
10	Të Dërguara me Postë	1135
11	Fatura tatimore të Qirasë	85
12	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë 1551.90 €	
	Gjithsej	26925

Spektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteve

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	6	100 faqe
2.	Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	6	89 faqe
3.	Nxjerrja e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	29	69 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	19	89 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	102	247 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	176	847 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	150	547 faqe
8.	Fotokopjimi	740	27000 faqe
9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	5	24 faqe

10.	Nxjerrja e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	5	18 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	21	75 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerrja e ekstraktit nga mbledhja e KKS	2	10 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	55	290 faqe
14.	Përgaditja e regjistrave të ndryshëm (për meditet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteteve e të ngjajshme).	48	105 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për veb faqe,dokumente të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	270	730 faqe
16.	Rregullore,Plan, Korniza e të ngjajëshme-	4 plane 1 Statut 1 Strategji	110 faqe
17.	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajëshme)	70	304 faqe
19.	Gjithsej	1706	30654 faqe dhe 247 orë përkthim me gojë (interpretim)
			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 118 orë përkthim në mënyrë verbale

Sektori për Mirëmbajtje dhe Operim

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Furnizim me lëndë djegëse - karburant për gjenerator dhe mesatarja e harxhimeve.	2	218.12 litra.
2	Furnizimi me lëndë djegëse /naftë/ për ngrohje qendrore	/	3000 litra.
3	Furnizim me lëndë djegëse – karburant për automjete	84	7307.23 litra karburante
4	Evidentimi i kilometrave të kaluara të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve.	84	85672 km mes; 8.52 lit/100 km
5	Harxhimet e ujit të pijshëm	/	m ³
6	Furnizim me material teknike për mirëmbajtje të objekteve		
7	Furnizim me material higjenik		
8	Ndërrimi – meremetimi i dorëzave për dyer të drurit	2	
9	Rregullimi dhe deblokomi i ujit nyjën sanitare		
10	Mirëmbajtja e higjienës në sipërfaqe	3/	3200 m ²
11	Mirëmbajtja e parkut - kositja e barit,		
12	Sërvisimi i automjeteve	9	
13	Sërvisimi i gjeneratorëve	/	
14	Sërvisimi i kalldatorëve	/	
15	Sërvisimi i centralit kundër zjarri (Alarmi)	/	
16	Sërvisimi i aparateve kundërzjarri	/	
17	Bartja e zyrtarve komunal ne trajnime-Prishtine me Kombi	342	
18	Vazhdimi i regjistrimit të automjeteve	9	
19	Mirëmbajtja e teknologjisë kompjuterike		
20	Vendosje e pompave zhytëse në pishinë	/	
21	Kërkesa për vetura zyrtare	1037	
	Gjithsej	1567	

Njësia për të Drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

Trajnime	Takime	Debate	Tryezë e rrumbullakët	Të ndryshme
15	13	1	0	Këshilla dhe sugjerime me palë në zyre 91

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ngritja e performancës së shëndetësisë në Komunën e Lipjanit dhe rangimi në vendin e dytë në Kosovë nga matjet e bëra dhe të publikuara së fundmi nga institucionet kredibile vendore dhe ndërkombëtare ka ndikuar në rritjen e motivit të personelit shëndetësor dhe në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Punës për vitin 2024 të cilat objektiva kanë të bëjnë më avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve cilësore shëndetësore.

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2024 kujdesi primar shëndetësor në Lipjan ka arritur rezultate të konsiderueshme në ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore për pacientët. Janë ofruar 266,887 vizita dhe shërbime shëndetësore me një rritje prej 13.3 % ose 35,549 vizita dhe shërbime më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Kjo periudhë raportuese ka qenë e sukseshme në realizimin e planit të vaksinimit si dhe vaksinimin e vajzave të klasave të gjashta kundër virusit Human Papiloma (HPV). Komuna e Lipjanit është ndër top komunat me përqindjen e realizimit të imunizimit.

Është formuar grupi punues dhe është hartuar Statuti i QKMF-së. Statuti i QKMF-së është aprovuar nga Asambleja Komunale e Komunës së Lipjanit më 29 Mars 2024 dhe është përcjellur në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal për aprovim të ligjshmërisë.

Ministria e Shëndetësisë ka rekomanduar të rishqyrtohet Statuti i aprovuar dhe të harmonizohet neni 11 i Statutit me formën Unike të Statutit nga MSh.

Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka rishqyrtuar Statutin e QKMF-së me datë 08.05.2024 duke vepruar konform rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë për harmonizimin e nenit 11 të Statutit me formën unike të Statutit nga MSh. Mirëpo, pas hyrjes në fuqi të Statutit të rishikuar dhe aprovuar nga Kuvendi Komunal dhe publikimit të tij në faqen zyrtare brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj, kemi pranuar një shkresë tjetër nga MSh përmes të cilës është rekomanduar prap të harmonizohen edhe nenet 5,7,9,12 dhe 23 me formën unike. Të gjitha këto nene, janë komplet identike me përjashtim të nenit 7 dhe 9 të cilat janë pothuajse identike me përjashtim të disa nënparagrafëve të cilët u janë përshtatur specifikave të QKMF-së në Lipjan, por duke e ruajtur përmbajtjen. Andaj, meqë kjo shkresë ka shkaktuar paqartësi, ngase nga i njëjti organ jep dy rekomandime të ndryshme për një akt, Komuna e Lipjanit ka kërkuar të anulohet shkresa e dytë dhe të konfirmohet ligjshmëria e Statutit të aprovuar nga Kuvendi Komunal.

Ende nuk kemi pranuar një përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë rreth shkresës të cilën e ka dërguar Komuna e Lipjanit për ligjshmërinë e Statutit të QKMF-së të aprovuar nga Kuvendi Komunal duke u bazuar në rekomandimet e tyre. Është e rëndësishme që ministria në fjalë të mos tejkaloj afatet e përcaktuara ligjore për kthim të përgjigjës rreth ligjshmërisë ngase funksionaliteti i QKMF-së varet drejtpërdrejtë nga ky statut.

Gjatë kësaj periudhe kemi rumbullaksuar përpjekjet tona duke adresuar në tërësi objektivin strategjik krijimin e kushteve infrastrukturore për implementim të plotë të mjekësisë familjare respektivisht zonimit, me theks të veçantë riorganizimin e ordinancave brenda QKMF-së, QMF në Gadime dhe QMF në Janjevë. Këto përmirësime të dukshme infrastrukturore kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në organizimin më të mirë të punës, përmirësimin e kushteve për mjekët dhe infermierët si dhe krijimin e mundësive për ofrim të shërbimeve më kualitative mjekësore.

Përmirësimi i kushteve, fuqizimi i stafit infermieror dhe mjekëve familjar është duke dhënë rezultat të mirë. Në QKMF ordinancat e mjekëve familjar janë duke funksionuar mirë. Stafit infermieror është i kyqur drejtëdrejtë në shërbim. Ndarja e detyrave të stafit infermieror dhe bashkëpunimi i duhur në mes të infermierëve dhe mjekëve familjar gjatë ofrimit të shërbimit është duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Planifikimi i hershëm për fuqizimin dhe përmirësimi i shërbimeve të urgjencës ka dhënë rezultate të mira. Shërbimi i urgjencës është plotësuar me numër të nevojshëm të mjekëve dhe infermierëve. Kushtet e punës janë përmirësuar në këtë shërbim. Urgjenca është e furnizuar me aparatura dhe pajisje të reja mjekësore si dhe autovetura të mirëmbajtura mirë dhe të gatshme për intervenim për shërbime akute dhe urgjente. Infermierët e propozuar nga shërbimi i urgjencës janë licencuar për ngasje të shpejtë, dhe tani janë duke ndikuar në ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe më cilësore.

Gjatë kësaj periudhe, kemi avancuar dukshëm me shërbimet laboratorike duke arritur të sigurojmë qëndrueshmërinë në ofrimin e 43 testeve/analizave laboratorike për pacientët e Komunës së Lipjanit dhe atyre që marrin shërbime në institucionet tona shëndetësore. Jemi ndër komuant e pakta që ofrojmë numër kaq të lartë të analizave.

Kjo është arritur duke i kyqur personelin e laboratorit në vendimmarrje, duke konsultuar resurset dhe kompetencat në këtë shërbime dhe duke plotësuar nevojat e këtij shërbimi me aparatura të reja biokimike dhe hematologjike si dhe duke i siguruar material të mjaftueshëm laboratorik.

Marrë parasyshë se kemi arritur të përmirësojmë kushtet e punës në sektorin e Stomatologjisë duke furnizuar këtë sektor me katër karrige të reja stomatologjike, dhjetë sterilizator, dy autoclav, material stomatologjik dhe pajisje e instrumente të mjaftueshme stomatologjike, numri i pacientëve të cilët marrin shërbime po vazhdon të rritet.

Shërbimi i vizitave në shtëpi për nënat dhe fëmijët deri në moshën 3 vjecare në Sektorin e Gjinekologjisë dhe Maternitetit është duke vazhduar. Draft Procedura Standarde e cila është afër fianlizimit, ka dhënë efektin e sajë në planifikimin e vizitave, referimin, administrimin dhe ndarjen e detyrave, realizimin e vizitave dhe monitorimin e raportimin e vizitave të realizuara. Ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm të këtij shërbimi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Futja në funksion e rëntgenit të ri në QKMF ka bërë diferencën në ofrimin e shërbimeve. Përveç eliminimit të kohës së pritjes për marrje të shërbimeve të rëntgenit, është përmirësuar ndjeshëm edhe kualiteti i shërbimeve imazherike.

Shërbimi i paliativit është zgjeruar me staf dhe është zgjatur orari i këtij shërbimi duke kaluar në dy ndërrime nga ora 07:00 deri në ora 23:00. Në muajt në vazhdim, do të angazhohemi për të parë mundësinë e ofrimit të shërbimeve të paliativit dhe vizitave në shtëpi edhe gjatë ditëve të vikendeve.

Është zhvilluar kampanja informuese për përzgjedhjen e mjekut familjar e udhëhequr nga MSh. Qytetarët e komunës së Lipjanit janë informuar se si mund të aplikojnë në e-Kosova për përzgjedhjen e mjekut të tyre familjar dhe në të njëjtën kohë, qytetarët kanë aplikuar për përzgjedhjen e mjekut të tyre familjar.

Dhoma për promovim dhe edukim shëndetësor (këshillimorja) është zgjeruar dhe është plotësuar me staf. Tani janë të caktuar katër infermiere për të ofruar shërbimet e kujdesit të integruar për pacientët geriatrik 65+ me sëmundje kronike jo ngjitëse si diabeti, hipertension, astma etj.

Është implementuar me sukses fushata e vaksinimit me HPV vaksinën për klasat e gjashta për nxënëset e gjinisë femërore dhe është realizuar vaksinimi. Sipas raportit të pranuar nga QKMF, respektivisht nga sektori i vaksinimit, është shënuar një sukses i lartë dhe koordinimi me Drejtorinë e Arsimit dhe shkollat ka qenë i mirë.

Kujdes i veçantë i është kushtuar higjienës në ambientet e institucioneve shëndetësore në Komunën e Lipjanit me qëllim të ofrimit të sigurisë për pacientin dhe personelin shëndetësor. Si rezultat, është shënuar avancim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastertinë brenda ambienteve të QKMF-së. Për së afërmi është monitoruar furnizimi i ordinancave me material dezinfektues dhe higjienik si dhe pajisja e secilës ordinancë dhe sallës me carcaf të ri.

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është duke u bërë avancim dhe jemi duke e përcjellur për së afërmi këtë proces. Përmirësimi i kushteve për stafin mjekësorë dhe për pacientin si dhe ofrimi i shërbimeve adekuate është trajtuar me kujdes.

Furnizimi me material mjekësor dhe laboratorik është kryer sipas kërkesave nga shefat e sektorëve, mirëpo furnizimi me barna dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë nuk është duke u bërë në tërësi. Furnizimi me insulinë është duke u bërë me vonesë nga depo qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë ndërsa furnizimi me barna për hipertension nuk është duke u bërë me rregull, ka mungesë për periudha të gjata kohore dhe kemi probleme të mëdha.

Bashkëpunimi me AQH-në rreth implementimit të planeve dhe projekteve për insitucionet shëndetësore në Komunën e Lipjanit ka qenë i shkëlqyeshëm.

Në këtë periudhë raportuese kemi përkrahur projektin kujdesi për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeçare. Do të vazhdojmë me përkrahjen dhe kemi siguruar një veturë për kryerjen e vizitave në terren.

Përgatitjet për të menaxhuar ikjen e mjekëve nga vendi dhe ose kalimi i tyre në biznes privat janë bërë dhe kemi filluar procedurat e rekrutimit me kohë.

Projektet kapitale të realizuara dhe në proces janë si vijon:

- Renovimi i infrastrukturës së jashtme në QMF Gadime dhe krijimi i parkingjeve të reja ka përfunduar dhe QMF është lëshuar në përdorim.
- Renovimi i QMF në Janjevë ka përfunduar dhe QMF është lëshuar në përdorim.
- Renovimi i AMF në Babush ka përfunduar dhe AMF është lëshuar në përdorim.
- Punët në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar sipas planit dinamik të projektit.

Është shënuar dita botërore kundër TB me 24.03.2024 përmes organizimit të aktiviteteve në sheshin Adem Jashari dhe organizimit të ligjëratave në QKMF-Lipjan.

Me 06 Mars 2024 në QKMF kemi pritur në vizitë Z. Lukas Rüttimann, Menaxher i Programit të SDC për Kosovën nga Bern, së bashku me ekipin e SDC-së në Kosovë dhe përfaqësuesit e AQH-së. Gjatë vizitës, së bashku me AQH-në prezantuar progresin e arritur në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët, si dhe identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim në të ardhmen. Komuna e Lipjanit dhe QKMF "Mehdi Zejnullahu" përmes projektit AQH, i financuar nga SDC dhe i zbatuar nga Sëiss TPH, përmes bashkëpunimeve të tilla synon të përmirësojë edhe më tutje qasjen dhe cilësinë e shërbimeve për të gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Kryetari i Komunës ka nxjerrë vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026 të QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu në Lipjan.

Është nxjerrë vendim për themelimin e grupeve punuese për hartimin e Procedurave Standarde të Operimit (PSO-ve) për:

- Procedura Standarde të Operimit (Pso) për vizita në shtëpi për shëndetin e nënës dhe fëmijës.
- Procedura Standarde të Operimit (PSO) për kujdesin e integruar për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse.
- Procedura Standarde të Operimit (PSO) për furnizimin me barna dhe material medicinal si dhe shpërndarjen e tyre në punkte dhe sektorët brenda QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu.
- Procedura Standarde të Operimit (PSO) për ofrimin e shërbimeve të paliativitetit dhe vizitave në shtëpi për pacientët imobil.

Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka finalizuar draftin fillestar të Planit të Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026 të QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu në Lipjan. Grupi punues do të takohet për hartimin e këtij dokumenti në muajin e ardhshëm.

Grupet punuese kanë filluar punën për hartimin e Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për vizita në shtëpi për shëndetin e nënës dhe fëmijës si dhe Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për furnizimin me barna dhe material medicinal si dhe shpërndarjen e tyre në punkte dhe sektorët brenda QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu.

Grupi punues për hartimin e Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për Furnizimin me Barna dhe Material Medicinal, Administrimin dhe Shpërndarjen e tyre në punkte dhe sektorët brenda QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu ka mbajtur dy takime.

Në muajin Qershor kemi bërë përgatitjet për rritjen e kapaciteteve dhe riorganizimin e punës në QKMF me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe përballje me rritjen e numrit të pacientëve si pasojë e ndryshimit dhe rritjes së temperaturave si dhe ardhjes së bashkëatdhetarëve nga diaspora gjatë muajve Korrik dhe Gusht.

Kemi ndërmarrë hapa konkret për fuqizim të shërbimit të urgjencës dhe përgatitjen për sezonin e verës, e cila shoqërohet me ndryshim të temperaturave. Shërbimi i Urgjencës ka burime të mjaftueshme njerëzore, kushte të mira logjistike dhe barna e material medicinal të mjaftueshëm për intervenime të shpejta akute dhe urgjente. Automjetet kanë qenë në gjendje të rregullt në sigurimin e ofrimit të shërbimit dhe servisimet janë kryer me kohë.

Është shtuar kontrolli i brendshëm dhe është hartuar Pani i Veprimit në të cilin specifikohet se menaxherët e kontratave do të kujdesen që faturat e operatorëve ekonomik të mos pranohen para se të lëshohet urdhërblerja. Kjo është komunikuar te menagjerët e kontratave aktuale. Më tutje, hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallrave dhe shërbimeve apo punëve, dhe pastaj pranohet fatura do të komunikohen nga autorizuesi i programit për çdo menaxher të ri të kontratës.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Totali i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore Janar-Qershor 2024

Janar-Qershor 2024-Vizitat mjekësore		
1	Vizita mjekësore nga mjeku familjar /përgjithshëm në QKMF	52455
2	Vizita mjekësore nga mjeku familjar /përgjithshëm në Punte	23829
3	Vizita mjekësore pediatrike	2498
4	Vizita mjekësore gjinekologjike	2270
5	Vizita mjekësore stomatologjike	4230
6	Vizita mjekësore pulmologjike	336
7	Vizita mjekësore emergjente	32700
8	Vizita në kujdesin paliativ	1111
9	Totali	119429
Janar-Qershor 2024- Shërbime shëndetësore		
1	Injeksione	50988
2	Infuzione	22608
3	Pastrim lidhje	9846
4	RTG	3060
5	Laborator	13693
6	Largim i penjve	589
7	Imobilizime të frakturave apo kontuzioneve	202
8	Oksigjenoterapi	636
9	EKG	2637
10	USG	838
11	Vizita shtëpiake me autoambulancë	487
12	Transport me autoambulancë	495
13	Vizita në qendren e paraburgimit	105
	Vizita në qendren e azilit Magure me ekipin nga urgjenca e QKMF-së	8
14	Rrahje	95
15	Këmbësor i lënduar me automjet	18
16	Konstatim vdekje	56
17	Aksidente trafiku	180
18	Dhunë familjare	7
19	Këshillimorja	15938
20	Vakcina	6244
21	Shërbime stomatologjike	7478
22	Referime	9915
23	Inhalime	440
24	Vizita infermiere gjinekologjike	247
25	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	372
26	Klasa për nëna	120
27	Thumbim i rriqërave	155
28	Lindje	1
29	Gjithsej shërbime	147458

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Sektori i Mjekësisë Familjare

Puna me mjekë ka qenë e organizuar mirë si dhe është bërë mbulimi i punkteve përveç AMF-Smallushë dhe AMF-Banullë që nuk kanë punuar, të cilat janë jashtë funksionit si pasojë e numrit të vogël të pacientëve.

Sektori i Infermierisë

Është arritë koordinimi i mirë në organizimin dhe shpërndarjen e punëve, si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës. Po ashtu janë organizuar trajnime të stafit dhe shënimi i ditëve të caktuara në shëndetësi. Ky shërbim po bart punën e kryerjes se stazhit të gjithë praktikantëve të infermierisë.

Sektori i Barnatores

Kemi një përmirësim në planifikimin, organizimin, administrimin dhe shpërndarjen e barnave. Jemi duke punuar në Procedurën Standarde të Operimit për Planifikimin, Administrimin, dhe Shpërndarjen e Barnave dhe Materialit Medicinal. Kjo PSO do të avancoj edhe më tutje menaxhimin e barnave.

Sektori i Shërbimit të Emergjencës

Stafi përbëhet nga 9 mjek, 16 teknik/infermier si dhe njësia e transportit me nga 1 vozitës për çdo ndërrim. Shërbimi i urgjencës dhe materniteti në QKMF ofron shërbime 24 orë në ditë.

Në këtë shërbim gjatë një ndërrimi, janë të angazhuar dy mjek dhe së paku katër infermier për arsye të vëllimit të madhë të punës dhe mundësia e daljes në teren të ekipës mjekësore me prezencën e mjekut. Ky shërbim është i ngarkuar me numër të madh të pacientëve. Me shume se gjysma furnizimit me material mjekësor dhe terapi shpenzohet nga ky shërbim.

Sektorin i Stomatologjisë

Pas pajisjes me karrige stomatologjike dhe autoclav kemi përmirësim të cilësisë së vizitave stomatologjike.

Sektori i Maternitetit

Vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjek gjinekolog. Ky shërbim ka shënuar rënie të lindjeve, por tani është orientuar në vizitat shtëpiake dhe këshillat për nena dhe fëmijë deri në tre vjeç dhe klasat për nena.

Sektori i Vaksinimit

Përveç realizimit të vaksinimit sipas planifikimit kemi realizuar edhe vaksinimin kundër virusit Human Papiloma (HPV) për vajzat e klasave të gjashta. Komuna e Lipjanit është ndër top komunat me përqindjen e realizimit të këtij aktiviteti.

Sektori i Laboratorit

Laboratori posedon aparaturë të mirë. Në shërbimin e laboratorit në QKMF ofrohen gjithsej 43 analiza.

Sektorin i Autogarazhes

Është bërë servisim me kohë dhe është bërë mbajtja në funksion të mirë të gjitha automjeteve të QKMF-së.

Departamenti i Administratës-Zyrtarja e lartë e personelit dhe administratë

Sektori i personelit të QKMF-së në Lipjan, duke u bazuar në dispozitat ligjore që janë aktualisht në fuqi, gjatë vitit 2024 ka kryer këto punë duke përpiluar këto akte juridike, si në vijim:

- Në sektorin e burimeve njerëzore janë zhvilluar procedurat e rekrutimit të pesë punëtorëve të rinjë, nga të cilët dy mjekë të përgjithëshem, dy stomatolog dhe një farmacist.
- Kompletimi i dosjeve të personelit.
- Përgaditjen e formularve për vlersimin e punëtorëve me punë dhe detyrat e punës dhe vlersimin nga ana e njesive relevante në QKMF.
- Konsultimi dhe dhënja e ndihmës juridike punëtorëve lidhur me të drejtat e tyre etj.

Nr.Rend	Emërtimi i Aktit	Nr. i aktive
1	Aktvendime (kërkesa për pushim) për shfrytëzim të pushimit vjetor të vitit 2024	50
2	Aktvendime për pagesën e punës së natës, jashtë orarit, gjatë festave	30
3	Kërkesë mbi masat disiplinore	/
4	Lëshime të vërtetimeve për provojë të punës për ish punëtorët dhe punëtorët aktual	20
5	Evidentimi dhe procedimi i pushimeve mjekësore	20
6	Evidentimi dhe procedimi i lindjeve në njësinë e maternitetit	/

7	Aktvendimet për pushimet e Lehonisë për punëtorët	1
8	Largim nga puna me vetë dëshirë dhe të larguar me procedurë të rregullt	2
9	Pushimet pa pagesë	1
10	Rekrutime të reja të punëtorëve	5
11	Vertetima që kanë përfunduar praktikën në QKMF	10
12	Autorizim e pregaditura nga asistentja e QKMF-së për fillim të praktikës profesionale dhe praktik vullnetare në QKMF	20
13	Aktvendime për daljen në pension të punëtorëve	1
14	Aktvendim për ndërprerjen e punës së punëtorëve që kanë vdekur	/
15	Aktvendime të ndryshme dhe shkresa të ndryshme.	50
16	Ndryshime në listen e pagave të punëtorëve për muajin prill 2024	60
17	Vertetima për provojë pune	10
Gjithësej:	Lëndet e punuara janë:	280

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Primar në Komunën e Lipjanit, përkundër vështirësive, nuk është ndërprerë asnjë shërbim dhe janë realizuar: **119429** vizita mjekësore dhe **147458** shërbime shëndetësore, gjithësej: **266887** vizita dhe shërbime shëndetësore. Ky numër i vizitave dhe shërbimeve, i cili është me i lartë se numri në periudhën e njejtë të vitit të kaluar, është rezultat i përmirësimit të ofrimeve të shërbimeve shëndetësore, si në infrastrukturë ashtu edhe në numrin e shërbimeve laboratorike.

Prioriteti i vitit 2024 do të jetë promovimi i KPSH-së dhe puna në teren në edukimin dhe promovimin e shëndetit, në veçanti me sëmundjet kronike jo ngjitëse, dhe grupet më të ndjeshme.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Qendra për Punë Sociale (QPS) si institucion publik profesional i nivelit Komunal, gjatë kësaj periudhe raportuese ka realizuar aktivitetet në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe veprimtarinë që bartë ky institucion.

Aktivitetet janë realizuar sipas funksioneve apo shërbimeve të organizuara në strukturën organizative të institucionit duke mos anashkaluar edhe bashkëpunimin në partneritet publiko-privat, përfshirë: OJQ lokale, vendore dhe ndërkombëtare, në dobi të institucionit dhe kategorive sociale, të specifikuara sipas veprimtarisë.

QPS, ka ofruar mbështetje për qytetarët në nevojë përmes shërbimeve, formave të mbrojtjes dhe intervenimeve në raste duke mos përjashtuar edhe përkrahjen materiale dhe ofrimin e shërbimeve administrative sipas detyrës zyrtare në kuadër të shërbimeve që funksionojnë brenda institucionit të QPS-së.

NUMRI I KLIENTËVE QË MARRIN SHËRBIME NGA QPS

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i rasteve
Fëmijë të braktisur	2	Këshilla martesore dhe sociale	39
Klient në nevojë për këshillim martesore	26	Besim i fëmijëve-kontakt	53
Fëmijët me sjellje asociale	48	Kujdestari	13
Të mitur konflikt me ligjin	120	Sh. Të miturve –delikuencë	168
Viktimat e dhunës	52	Vendosje në strehim familje	1
Fëmijë me AK	10	Vlerësime për të mitur	1
Fëmije të keqtrajtuar, abuzuar.	18	Vendosje adoptim vendor	1
Të moshuarit në nevojë për shërbime	1	Shërbime për fëmijët në spital	2
Klient për strehim familjar të fëmijëve	0	Vendosja e fëmijëve në strehim	1
Martesa të miturve	2	Bashkim familjar	3
Personat e rritur, të vendosur në Institucione	0	Strehim për viktimat e dhunës	1
Punë e rrezikshme e fëmijëve	0	Shërbime për fëmijët me AK.	122
Viktimat e trafikimit	0	Fëmijë në adoptim vendor	1
Viktimat e dhunës për strehim	2	Intervenimi i viktimave	49
Fëmijët e prindërve të penguar në detyrë prindërore.	0	Intervenim në kujdestari	79
Ri-integrim i fëmijëve	0	Shërbime për të rriturit me AK	0
Kujdestaria për fëmijë të pa shoqëruar	6	Sanim i marrëdhënieve familjare	1

Të moshuarit në nevojë për shërbime	1	Përfaqësues të përkohshëm	5
Viktimat e krimeve seksuale	4	Ndihmë materiale për fëmijët me AK	8
Klient tjerë me kërkesë për shërbime administrative dhe profesionale.	346	Intervenimet e përgjithshme	2321
Totali:	639	Totali	2917

SHËRBIMI I NDIHMAVE SOCIALE

Shërbimi i asistencës sociale si çdo herë edhe përgjatë këtij gjashtëmujori ka vepruar me aktivitet sipas plan programit për përfshirje sociale që në parim; askush mos të mbetet mbrapa, përkundër një periudhe jo të zakonshme dhe mjaft sfiduese, si rrjedhojë e reformës SAS, pilotimi SAS 2024.

Në vazhden e aktiviteteve sociale nuk ka munguar aktivitet mbështetës social me institucione, organizata dhe shoqëri civile, përfshirë: Bashkësinë Islame dhe Shoqatën Bereqeti, persona fizik dhe juridik të vullnetit të mirë. Punë të tjera administrative, siç janë vërtetimet që janë apo nuk janë në asistencë sociale, konstatime zyrtare etj.

Pasqyra e familjeve dhe pagesave në asistencë sociale.

MUAJI	NUMRI I FAMILJEVE	SHUMA
JANAR	1007	134,360.00
SHKURT	965	130,670.00
MARS	980	130,730.00
PRILL	1011	136,250.00
MAJ	963	130,080.00
QERSHOR	933	124,850.00

Projekti i reformës SAS të asistencës sociale në Kosovë përfshinë deri më deri më tani aplikime në komunën e Lipjanit mbi 2000 familje. Për këto raste QPS ka dhënë mbështetje në:

- Aplikim
- Identifikim të familjeve në rrezik social- informimin për aplikim dhe pilotim.
- Mbështetja e individëve në parashtrimin të ankesave në e-Kosova.

SHËRBIMI ADMINISTRATIVO - FINANCIAR

Shërbimi Administrativo-Financiar ka zhvilluar aktivitet në harmoni me legjislacionin përkatës për punë administrative dhe financiare, në kuadër të planit buxhetor dhe sipas afateve procedurale dhe planifikuese. Janë autorizuar mjetet dhe administruar të gjitha kërkesat në kohë dhe lëndët janë në zyre përkatëse ekzekutive në nivel komune.

Aktivitetet në nivel QPS-je.

1. Aktivitet në shërbime sociale dhe të mirëqenies, strategjike, planifikuese, mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse për grupet në nevojë:
2. Zbatim të strategjisë dhe planit të veprimit për shërbime sociale dhe familjare në QPS.
3. Zbatimi i plan-programeve në kuadër të QPS-ës dhe MM, siç është:
 - Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet (QKRMT) dhe Komunës.
 - Memorandum mirëkuptimi ndërmjet (SOS-fshatrave) dhe QPS, Komunës-Lipjan.
 - OFAP- mbështetja e fëmijëve në strehim familjar;
 - Shërbimet për fëmijë dhe foshnja
 - Shërbimet e integruara shëndetësore dhe Sociale për personat e moshuar me sëmundje kronike.

Arritjet në kuadër të QPS-ës:

- Qasje të barabartë për PAK, përmes projektit - "EU for ALL" për QPS-ën nga zyra BE në Kosovë dhe MAPL 2023/2024.
- Funksionimin i Tryezës për menaxhimin e rasteve sipas Rregullores Nr. 23/2023
- Ofrimi i shërbimeve sociale përmes ofrueseve të shërbimeve sociale dhe familjare në kuadër të QPS-ës.

REKOMANDIMET NË NIVEL QPS.

1. Digjitalizim i administratës në Qendrën për Punë Sociale, nevojë e kohës për evidentim elektronik të shkresave hyrëse dhe dalëse, për t'u liruar nga protokollimi dhe evidentimi manual, në kuadër të protokollit bazë në QPS, identifikuar dhe parashtruar si nevojë edhe më parë në administratën komunale dhe rekomanduar përmes raporteve vjetore.
2. Inkurajim dhe lidhje e MM nga Komuna me organizatat që ofrojnë programe për zbutje të varfërisë, dhe inkuadrim të kategorisë së dytë në punë publike, mbështetje me kredi, dhe donacione.
3. Program të arsimit për ngritje profesionale pa shkëputje nga puna për NAS me kualifikim të mesëm, dhe përvojë mbi pesë vite deri në 30 vite. Parashihet edhe me Rregullore për shërbyes civil.
4. Zhvillim i politikës lokale sociale në ofrim të shërbimeve mbështetëse të përkujdesjes së drejtpërdrejt – rastet sociale të kenë mundësi të marrjes së shërbimeve në komunitet. Kontraktim i OJQ-ve të specializuara për ofrim të këtyre shërbimeve në komunitet.
5. Zhvillim i strehimit familjar është pjesë e politikës lokale sociale për përkujdesje të fëmijëve pa kujdes prindëror, prandaj rekomandojmë fushatë sensibilizuese në promovimin e dy familjeve strehuese gjatë gjashtëmujorit të dytë 2022, kriter ky edhe ligjor.
6. Krijimi i Ueb faqes së QPS, nevojë e domosdoshme për informim të qytetarëve rreth aktiviteteve dhe misionit të QPS-ës.
7. Respektim të kërkesës për ri-shqim buxhetor nga QPS.

Qendra për Punë Sociale në Lipjan në bashkëpunim me strukturat vendimmarrëse në nivel Komunal dhe Qendror ka rezultuar të mbaj në nivel shërbimet, dhe të ketë performancë të mirë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024.

SHTËPIA ME BAZË NE KOMUNITET

Gjendja e përgjithshme e fillimit të vitit 2024 ka qenë e mirë dhe ka filluar si zakonisht me kryerjen e punëve dhe detyrave të zakonshme.

Edhe këtë vit kemi pas sigurimin fizik të objektit ku është lehtësuar puna për stafin shëndetësorë pasi që kanë punuar vetëm në shërbim të rezidentëve duke mos pasur obligime për pjesen e jashtme të objektit.

Gjendja shëndetsëore e rezidentëve gjatë kësaj periudhe në përgjithësi ka qenë e mirë në përjashtim të periudhes kur kishin disa kriza psikike që kanë pasur disa rezidentë, e ku në disa raste janë menagjuar nga stafi dhe në disa raste janë dërguar për kontrollat të vazhdueshme në klinikën e psikiatrisë në Prishtinë, ndërsa për rezidentet me probleme të vogla shëndetësore kemi bashkëpunuar me QKMF- në-Lipjan ku sipas nevojave për vizita i janë përgjigjur thirrjeve nga stafi i Shtëpisë me bazë në Komunitet.

Gjatë kesaj periudhe kemi pasur vizitë nga menagjeret ligjor të rezidentëve nga Qendra për Punë Sociale-Lipjan, vizita nga shtëpitë tjera të komunitetit në nivel të Kosovës, vizita nga familjarët e rezidentëve, vizita nga organi kompetent nga Ministria e Përkujdesjes Sociale dhe monitorim nga inskriptoriati i punës nga niveli qendror.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur të arritura të ndryshme si ushqyeshmerin e rezidentëve në menyrë të shëndetshme dhe dietale simbas llojit të diagnozes, mbajtje të hixhienes së mirë të rezidentëve, shpërndarjen e terapisë në manyr të rregullt, menagjimin e të gjitha situave rreth krizave psikike të rezidentëve, menagjimin e mirë rreth përkujdesjes së gjendjes shëndetësore, mirembajtjen e oborrit ,mirëmbajtjen e higjienes së hapësires së brendshme të objektit, aktivitete me rezidentë, ,furnizim me paisje të nevojshme për shtëpi, kryerjen e obligimeve të kujdestarive të stafit kujdestarë , kryerjen e të gjitha obligimeve komunale, kryerjen e të gjitha obligimeve rreth furnizimeve të ndryshme që kemi pasur për kete vit, sigurim fizik gjë që na lehtëson punën direkt me rezidentë.

STRUKTURA MOMENTALE E REZIDENTËVE NË SHTËPINË E KOMUNITETIT- LIPJAN:

STRUKTURA E REZIDENTEVE				
NACIONALITETI	NUMRI	FRMRA	MESHKUJ	
SHQIPËTAR	8	4	4	
ROM	1	1		
BOSHNJAK	1	1		
NUMRI I PERGJITHSHEM	10	6	4	

DREJTORATI PËR ARSIM

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Ofrimi i kushteve dhe arritja e rezultateve të kënaqshme në aspektin edukativo-arsimor janë çështje të cilat DKA në vazhdimësi mundohet t'i arrijë me punë dhe aktivitete të ndryshme, gjithmonë duke synuar më të mirën për shkollën, veqanërisht përmirësimin e nevojave primare të cilat ndikojnë pozitivisht në realizimin sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor. Ngritja e cilësisë në mësim, në veçanti përmirësimi i praktikave vlerësuese të nxënësve, kanë qenë dhe janë prioritet në mënyrë që shkollat tona të arrijnë në stadin e shkollave të përparuara në aspektin zhvillimor.

Sistemi arsimor në Komunën e Lipjanit organizohet në nivelet **0, 1, 2** dhe **3 sipas ISCED-it**, me gjithësej **28** Institucione Arsimore, prej të cilave **1** Institucion për edukimin parashkollor me 4 njësi fizike të ndara në 4 fshatra, **24** SHFMU dhe **3** SHML - një shkollë Gjimnaz, një shkollë Profesionale dhe një shkollë Mikse.

Komuna e Lipjanit, respektivisht Drejtoria Komunale e Arsimit, ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi me Ipkofondation.

Nga kjo marrëveshje përmes garave me projekte konkrete kanë përfituar 10 (dhjetë) ekipe nxënësish nga shkolla të ndryshme të Komunës së Lipjanit. Vlera financiare për secilin ekip fitues është 1000 mijë euro.

Përfundimi i gjysëm vjetorit të parë më datë **12.01.2024** dhe fillimi i gjysëm vjetorit të dytë më datë **24.01.2024**.

Hartimi dhe dorëzimi i planit të zotimit dhe shpenzimit në buxhet.

Evidentimi dhe pasqyrimi i borqeve nga viti 2023 në pasqyrat financiare.

Përgatitja dhe dërgimi në buxhet i formularëve për deponimin e nënshkrimit për të gjithë autorizuesit e shpenzimit në nivel shkolle.

Nga Agjencia e Lajmeve KOSOVAPRESS është mbajtur Trajnimi -Edukimi mediatik kundër Dezinformimit për nxënësit nga komunitetet jo shumicë në Kosovë, në të cilin trajnim kanë marrë pjesë nxënësit nga shkollat SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan dhe SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan.

Pjesëmarrja e zyrtarit për arsim në punëtorinë **"Shkëmbimi i praktikave ndërmjet anëtarëve, tryezave ndihmë në menaxhimin e rasteve"**, kjo punëtori është zhvilluar në kuadër të projektit përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së kujdesit dhe shërbimeve sociale dhe edukative për vajzat dhe djemtë në nevojë. Projekt i mbështetur nga Zyra e Bashkimit European dhe zyra e UNICEF-it në Kosovë.

Për nder të festës së 7 Marsit Ditës së Mësuesit, DKA ka organizuar takim me drejtorët dhe mësime të cilin takim u ndanë mirënjohje për mësime të dalluar në nivel shkolle. Gjithashtu është bërë përzgjedhja e punëtorit më të mirë në nivel Komune për vitin 2024. Të gjitha shkollat e kanë shënuar këtë ditë me organizime festive.

Më datë **01.03.2024** mbështetur nga Komuna e Lipjanit për herë të parë në Komunën e Lipjanit ka filluar kuizi i diturisë nën organizimin e SHFMU "Ismail Luma" në Lipjan. Ky kuiz është organizuar për 21 shkolla të Komunës së Lipjanit, duke përfshirë edhe shkollat private me nxënës nga klasa e 6-gjashtë deri në klasën e IX-nëntë. Kuizi është dizajnuar në 9 fusha të ndryshme duke ofruar sfida dhe mundësi të reja për nxënës. Finalja e kuizit të diturisë është mbajtur më datë 19.04.2024 dhe në bazë të rezultateve të pesë ditëve garuese, të drejtën për të garuar në finale e fituan ekipet e këtyre shkollave: Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve Shfmu "Hasan Prishtina", në Llugaxhi, Shfmu "Ismail Luma" në Lipjan, Shfmu "Nezë Bujani" në Bujan dhe Shfmu "Emin Duraku" në Banullë. Pas një gare korrekte, fitues i finales së Kuizit të Diturisë 2024 u shpall Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve.

Komisioni komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka vazhduar me vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta, konform kërkesave nga drejtorët e shkollave.

Është lidhur kontrata dhe kanë filluar shërbimet e internetit në të gjitha shkollat-paralele të ndara fizike.

Është lidhur kontrata dhe kanë filluar shërbimet e sigurimit fizik në 3-tre shkollat e qytetit: SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan dhe SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan.

Në kuadër të investimeve kapitale në shkoila ka përfunduar renovimi i shkollës së mesme mikse në Shalë dhe kanë rifilluar punimet në renovimin e shkollave në Topliqan, Rufc I Ri dhe Medvec.

Është bërë:

- Instalimi i kamerave në shkollën e fshatit Sllovi.
- Furnizimi dhe rregullimi me dyer në shkollat në Qyragë dhe Konjuh.
- Rregullimi i kulmit në shkollat në Bujan dhe Kraishtë.
- Furnizimi me inventar shkollor i shkollës "Kadri Beba" në Ribar i Madh
- Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse dru zjarri për vitin 2024/2025.

Janë subvencionuar disa fëmijë me nevoja të veçanta, disa prej tyre që vijnë në mësimin në Qendrën për Autizëm në Banullë e disa prej tyre që vijnë në shkollimin në Qendrën "Përparimi" në Prishtinë.

Në kuadër të aktiviteteve për "Javën e Tokës" në tri shkollat e mesme të Komunës së Lipjanit është bërë mbjellje e drunjëve në oborrin e shkollës "Adem Gllavica" Lipjan SHMLM "Shaqir Hoxha" në Shalë dhe SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan. Gjithashtu është mbajtur Kampanjë vetëdijësuese "Reduktimi i qeseve plastike" përmes shpërndarjes së broshurave informuese dhe çantave shumë përdorimshe në sheshin e Lipjanit.

Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan si qdo vit ka organizuar panairin e Gjuhës, Artit, Shkencës dhe Teknologjisë P-GJASHTË 2024, në të cilin panair kanë marrë pjesë të gjitha shkollat fillore të Komunës së Lipjanit.

Nxënës të Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan dhe Shfmu "Nezë Bujani" në Bujan kanë marrë pjesë në panairin ASEF ALBANY në Tiranë të cilët janë mbështetur nga Komuna e Lipjanit. Nxënës pjesëmarrës kanë treguar rezultate shumë të mira dhe kanë marrë qmime të ndryshme. Nxënësi i klasës së 5-të nga shkolla "Vëllezërit Frashëri" Jeton Sylejmani ka marrë pjesë në gara të matematikës në Holandë dhe ka fituar vendin e dytë.

Është realizuar ekskurzioni për nxënës semimaturant dhe maturant.

Më datë 29.05.2024 është bërë hapja e Çerdhës së re në fshatin Rufc I Ri.

UNICEF-i ka bërë furnizimin me lodra për fëmijë për Çerdhën në Rufc dhe Shfmu "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe.

Përgatitja teknike për mbajtjen e testeve: Testin TIMSS, testin e arritshmërisë dhe maturës për vitin shkollor 2024/2025.

Përgatitja dhe dërgimi i të dhënave në MASHT për planifikimin e nxënësve në klasën e 10-dhjetë për vitin shkollor 2024/2025.

Është bërë përzgjedhja e nxënësve të klasëve të XI-njëmbëdhjeta që të marrin pjesë në programin "Edukimi për Siguri". Nxënësit e dy klasave të 8-ta të shkollës "Kadri Beba" Ribar i Madh janë përzgjedh për aktivitetin e organizuar nga Federata e sportit shkollor " Drejt malit"

Finalizimi i draft planit të veprimit kundër brakstisjes dhe mos regjistrimit dhe inicimi i procedurës për miratim në Kuvend.

Ashtu siq është e përcaktuar me ligj në tërë territorin e Komunës së Lipjanit është kryer transporti për të gjithë fëmijët nga klasa e I-parë deri në klasën e IX-nëntë.

Nënalokimi i mjeteve

Zotimi i mjeteve në të gjitha kategoritë: (mallra&komunali) dhe nivelet (administratë, parafilor, fillor dhe të mesme).

Menaxhimi i kontratave për furnizime dhe shërbime.

Hartimi, përgatitja dhe dërgimi i kërkesës për buxhet sipas qarkores 2023/2025.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë dhe
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Janë realizuar aktivitete kulturo-artistike me rastin e shënimit të ditëve të shkollave në:

- Shfmu "Ismail Luma" në Lipjan,
- Shfmu "17 Shkurti" në Gillogovc,
- Shfmu "Vezir Kolshi" në Baicë,
- Shfmu "Haradin Bajrami" në Magure,
- Shfmu "Hasan Prishtina" në Llugaxhi,
- SHMLM "Shaqir Hoxha" në Shalë,
- SHFMU "Kadri Beba" Ribar i Madh,
- Shfmu "Emin Duraku" në Banullë,
- Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve,
- Shfmu "Katër Dëshmorët" në Krojmir,
- Shfmu "Skenderbeu" në Kraishtë,
- Shfmu "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë,
- Shfmu "Ibrahim Banushi" në Shalë,
- Shfmu "Zenel Hajdini" në Gadime,
- Shfmu "Ibrahim Krasniqi" në Smallushë,
- Shfmu "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe dhe
- Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan.

Janë realizuar kërkesa të ndryshme dhe ate:

Kërkesë DP-së për zhvillimin e procedurës:

- Demolimi, furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve në disa IEA-Kontratë dy vjeçare
- Furnizimin me Çerdhe me pajisje shtëpiake dhe klima
- Furnizimi e Çerdhës në Rufc me pajisje të ndryshme dhe inventar
- Furnizimi i Çerdhës me materiale të imta shtrojë e mbulojë
- Furnizimi me artikuj të ndryshëm për dita të shkollës-kontratë dy vjeçare
- Furnizimi me material për mirëmbajtje të shkollave-kontratë kornizë dy vjeçare
- Furnizimi me material higjienik për IEA-Kontratë kornizë 2 vjeçare

- Instalimi i internetit dhe shërbimet e rregullta mujore për paralelet e ndara fizike të IEA (Kontratë kornizë) për periudhën dy vjeçare
- Mirëmbajtja dhe servisimi i klimave dhe pajisjeve në IEA-Kontratë dy vjeçare
- Riparimi i defekteve dhe rregullimi i klimave në IEA-Kontratë kornizë dy vjeçare.
- Sigurimin fizik të objekteve në shkollat Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan dhe SHML Gjinnazi "Ulpiana" në Lipjan-kontratë kornizë dy vjeçare.
- Trasporti i nxënësve në garat ndërkombëtare në Tiranë në relacionin Lipjan-Tiranë dhe anasjelltas.
- Kryerjen e shërbimeve të DDD në IEA-kontratë dy vjeçare.
- Furnizimin me pemë dhe perime.
- Servisimin e gjeneratorëve-kontratë kornizë dyvjeçare.
- Furnizimin dhe montimin e xhamave në të gjitha IEA-kontratë kornizë dy vjeçare.
- Ndërtimi i infrastrukturës në oborrin e shkollës fillore në fshatin Ribar i Madh
- Demolimi i objektit të shkollës së vjetër Adem Gllavica dhe shkollës në Resinocv
- Rregullimi i parketit në shkollën e fshatit Topliqan
- Izolimi dhe ngyrosja e shkollës në Bujan
- Gletimi dhe ngyrosja në shkollat: Qylagë dhe Sllovi

Kërkesë Departamentit të Urbanizmit për hartimin e paramasës dhe parallogarisë për:

- Rregullimi i oborrit në shkollën në Rufc dhe
- Rrenimi i objekteve të dëmtuara në Risinocv dhe SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan

Kërkesë Thesarit për:

- Rexhistrimin e furnitorëve të ri në SIMFK.

STATISTIKAT

TESTI TIMSS 2024

Nr.	Komuna	Shkolla	Kodi i shkolles	Klasa e perzgjdhur	Nr. i nxenesve	Emri i mesueses	Emri i koordinatorit te shkolles	Nr. i telefonit	Qendra e testimit	Datat
19	Lipjan	Hasan Zuko Kamberi	1124	V/1	20	Albulene Avdyli	Bekim Hasani	4E+07	SHFMU "Ismail Luma" - Lipjan	5 qershor 2024
		Vëllezërit Frashëri	1058	V/1	42	Tefik Rashiti	Avdi Azemi	5E+07	SHFMU " V. Frashëri " Lipjan	5,6,7 qershor/ 2024
				V/4	42	Valbona Bërbatovci				
		Zenel Hajdini	1121	V/1	23	Yllka Ademi	Hyrzeme Kaqara, zv.drejtoresha e shk.	4E+07	SHFMU " Zenel Hajdini " - Gadime	3,4 qershor 2024
				V/3	19	Ajshe Gërbeshi Ejupi				
				V/4	5	Lumturije Sinani				
				V/5	2	Antigona Demiri				
Emin Duraku	1125	V/2	15	Fjolla Fetahu	Emine Mulaj	4E+07	SHFMU "Emin Duraku " Banullë	6 qershor 2024		

Rezultatet e testit të arritshmërisë në nivel komune për vitin shkollor 2023-2024

Nr.	Shkolla	Nr I nxënësve	Përqindja e kalueshmërisë në testin e arritshmërisë
1	SHFMU " VËLLZËRIT FRASHËRI "	197	54.04
2	SHFMU "ISMAIL LUMA "	74	35
3	SHFMU "ZENEL HAJDINI "	42	44.54
4	SHFMU "DY DËSHMORËT"	27	40
5	SHFMU " IBRAHIM BANUSHI "	28	42
6	SHFMU "HARADIN BAJRAMI "	63	41

7	SHFMU "EMIN DURAKU "	25	53
8	SHFMU " HASAN Z KAMBERI "	49	41
9	SHFMU "MIGJENI "	33	44.86
10	SHFMU " ERNEST KOLIQI "	28	51
11	SHFMU " SHTJEFËN GJEQOVI "	15	40
12	SHFMU " KADRI BEBA "	38	43.03
13	SHFMU " SKENDERBEU "	19	39
14	SHFMU " KATËR DËSHMORËT "	21	39
15	SHFMU " V .DOMANEKU "	11	40
16	SHFMU " HASAN PRISHTINA "	18	52
17	SHFMU " IBRAHIM KRASNIQI "	18	48
18	SHFMU NEZË BUJANI "	13	47
19	SHFMU " FEHMI AGANI "	12	41
20	SHFMU " DRITA "	7	52
21	SHFMU " REGJEP AKLLAPI "	7	36
22	SHFMU "VEZIR KOLSHI "	26	39
23	SHFMU " 7 MARSII "	15	49
24	SHFMU - "17 Shkurti" GLOGOVCI	15	41
	Gjithësejt	801	45.33

REZULTATET E TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE,AFATI I QERSHORIT 2024

GJIMNAZI"ULPIANA"LIPJAN

DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHSEJ NXËNËS
NATYROR	181	84.58	33	15.42	214
SHOQËROR-GJUHËSOR	156	54.55	130	45.45	286
GJITHSEJ	337	67.40	163	32.60	500

SHMP"ADEM GLLAVICA"LIPJAN

DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
EKONOMI	19	47.50	21	52.50	40
ADMINISTRATË	19	43.18	25	56.82	44
KIMI-TEKNOLOGJI	5	35.71	9	64.29	14
BUJQËSI	1	25.00	3	75.00	4
ELEKTROTEKNIKË	11	50.00	11	50.00	22
MAKINERI	3	60.00	2	40.00	5
NDËRTIMTARI	12	63.16	7	36.84	19
GJITHSEJ	70	47.30	78	52.70	148
SHML"SHAQIR HOXHA" SHALË					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
NATYROR	3	27.27	8	72.73	11
SHOQËROR-GJUHËSOR	5	41.67	7	58.33	12
EKON:BANKA DHE FINANCA	0	0.00	2	100.00	2
GJITHSEJ	8	32.00	17	68.00	25

NIVEL KOMUNE

POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
415	61.66	258	38.34	673

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takim me përfaqësuesit e organizatës joqeveritare “Qendra për informim kritik dhe aksion-Instituti QIKA, me temën luftimi i gjuhës së urrejtjes përmes rishikimit dhe hartimit të rregullave të shkollave në Komunën e Lipjanit.
- Takim me sekretaren e MASHT-it në të cilin takim është diskutuar për përfundimin e ndërtimit të objektit shkollor SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan.
- Takim me përfaqësuesit e organizatës joqeveritare VORAE, qëllimi i takimit ishte marrja e informatave nga DKA-të rreth funksionimit të qendrave mësimore.
- Takime me përfaqësuesit e IHDNJ-Instituti për Hulumtime dhe Të Drejtat e Njeriut, qëllimi i takimit ishte realizimi i projektit “Thuaj jo fjalës së urrejtjes dhe ngacmimit seksual”.
- Takim me përfaqësuesit UNICEF-it për të prezantuar projektin e ri të UNICEF/IOM të quajtur “Fuqizimi i të rinjve përmes shkollave dhe shoqërive gjithëpërfshirëse (YESS)”.
- Takime të ndryshme me qytetarë, përkthazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin.
- Takime me drejtor të shkollave rreth çështjeve që ndërlidhen me procesin edukativo-arsimor.

SFIDAT

- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t’i vlerësoj të gjithë në kohë reale.

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Raporti gjashtëmujor për periudhën janar – qershor i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport reflekton përpjekjet dhe arritjet e këtij drejtorati në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, aktiviteteve rinore dhe ngjarjeve sportive të organizuara në këtë periudhë. Raporti synon të paraqesë një pasqyrë të plotë dhe objektive të kontributit të Drejtoratit tonë në promovimin e kulturës, rinisë dhe sportit në komunitetin tonë gjatë këtij gjysmëvjeçari.

AKTIVITETET GJATË PERIUDHËS KOHORE Janar- Qershor 2024

Sektori i sportit

Gjatë periudhës gjashtë mujore kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme:

1. Përkrahja e turnireve sportive për nder të ditëve së dëshmorëve dhe organizimi i turnireve të veçanta për secilin dëshmor (DKRS ofron mbështetjen financiare, kurse me organizimin merren këshillat organizativ të turnireve),
2. Turniri tradicional “Kupa e Pavarësisë 2024”,
3. Subvencionimi i klubeve sportive përmes thirrjes publike dhe nënshkrimi i kontratave me 18 OJQ-të sportive
4. Aktivitete sportive për nder të ditës së fëmijëve,
5. Aktivitete të mbështetura dhe të organizuara nga DKRS, siq janë:
 - Futboll i vogël,
 - Gara në volejball,
 - Sport për persona me aftësi të kufizuara,

- Ecje në natyrë,
 - Garë vrapimi etj.
6. Kemi takuar OJQ-të sportive dhe i kemi njoftuar për programin e DKRS-së për vitin 2024,
 7. Janë ndarë terminet e klubeve në sallat sportive që menagjohen nga DKRS,
 8. Është transmetuar në shesh ndeshja në mes të Shqipërisë dhe Spanjës,
 9. Klubet sportive kanë qenë pjesë e diskutimeve publike për hartimin e buxhetit 2025-2027.

Sektori i rinisë

Gjatë periudhës gjashtë mujore kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme:

Gjatë kësaj periudhe **Janar – Qershor 2024**, Departamenti për Infrastrukturë ka përgaditur dhe proceduar në Departamentin e Prokurimit për të publikuar pjesën dërmuese të projekteve të planifikuara në kuadër të Departamentit për Infrastrukturë, si dhe ka përgaditur paramasat dhe parallogaritë për projekte të cilat janë në kuadër të Departamenteve tjera.

Përveq projekteve të parapara në buxhetin e Komunës për vitin 2024 Drejtoria për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka paraqitur kërkesa në Ministrinë përkatëse për projekte të tjera me bashkëfinancim siç janë:

1. Ndërtimi I rrugës Topliqan-Kojuskë
2. Ndërtimi I Urës mbi Lumin Sitnica
3. Asfaltimi I rrugicave në lagjët e fshatrave: Krojmir, Kraishtë, Vërrshevc, Poturovc, Llugaxhi, Gumnasellë, Magure, Torinë, Glogovc, Konjuh
4. Vazhdimi I Ndërtimit të shtratit të lumit në fshatin Gadime e Epërme
5. Vazhdimi I ndërtimit të shtratit të Lumit në fshatin Gadime e Ulët.
6. Vazhdimi I ndërtimit të shtartit të lumit në fshatin Smallushë.
7. Rikonstruimi I rrugës Lipjan – Rubovc
8. Rikonstruimi I rrugës Ribar I Vogël - Ribar i Madhë
9. Rikonstruimi I rrugës Poturovc Ribar i Madhë
10. Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Medvec faza II

Memorandumet

Kryetari i Komunës ka nënshkruar Memorandum bashkëfinancimi me MMPHI në vlerë prej 370.000.00 Euro për projektin: **Ndërtimi i Urës mbi Lumin Sitnicë**. 70 mijë euro janë të ndara për vitin 2024 ndërsa mjetet e tjera janë për vitet e ardhshme.

Ndërsa Komuna e Lipjanit do të participoj në vlerë prej 30,000.00 Euro.

Ndërsa vazhdon Memorandumi me MZHR "Rehabilitimi i qendrës kulturore në Janjevë" në vlerë 250,000.00 Euro të ndara në dy vite 2023 - 2024. Në këtë projekt me marrëveshje bashkëfinancimi Komuna e Lipjanit do të participoj në vlerë prej 200,000.00 Euro të ndara në dy vite.

Ecuria e projekteve

Gjate kësaj periudhe kanë vazhduar punimet në projektet të cilat i kemi lidhur kontratat në vitin 2023 disa kanë përfunduar, Ndërsa projektet për të cilat kemi lidh kontrat në vitin 2024 kanë filluar punimet dhe janë duke vazhduar sipas planit, disa projekte tjera janë në procedurë të prokurimit.

Lista e projekteve nga Drejtoria për Infrastrukturë

1	Ndërtimi i trotuarit në rrugën Gadime-Llugaxhi	I përfunduar
2	Ndërtimi i trotuarit në Krojmir	I përfunduar
3	Aneks të rrjetit të Kanalizimit në Lipjan, Aklap, Krojmir, Rubovc, Silovi, Grackë, Mirenë, Babushë	I përfunduar
4	Asfaltimi i rrugicave në Krojmir, Shalë, Resinoc, Qylagë, Magure, Vërshevc, Baic, Kraishtë Faza III	I përfunduar
5	Asfaltimi i rrugicave në Silovi	I përfunduar
6	Asfaltimi i rrugicave në Krojmir, Shalë, Resinoc, Qylagë, Magure, Vërshevc, Baic, Ribar i Madh, Gumnasell	I përfunduar
7	Ndërtimi i rrugës së Lumit deri tek Rruga e Shkupit	I përfunduar
8	Asfaltimi i rrugicave në Krojmir, Shalë, Resinoc, Qylagë, Magure, Vërshevc, Baic, Kraishtë	I përfunduar
9	Ndërtimi i nënkalimit dhe vazhdimi i ndërtimit të sheshit dhe Ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe Parkingut nëntokësor në Lipjan	Në implimentim
10	Hapja dhe ndërtimi i rrugëve të reja brenda në Qytetin e Lipjanit (Rruga Arfim Zhitia, Rr. Bashkim Krasniqi-te rr. Haradin Bajrami- rr. Haxhi Kleqka,	Në implimentim
11	Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Silovi, Gadime, Smallush, Gomaselle, Llugaxhi, Babushë.	Në implimentim
12	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe asfaltimi i rrugicave në Kleqk	Në implimentim
13	Rehabilitimi i infrastrukturës në Janjevë	Në implimentim
14	Rikonstruimi i rrugës Fehmi Agani	Në implimentim
15	Rikonstruimi i rrugës së shkollës në Dobraj të Madhe dhe rrugicat tjera	Në Tenderim
16	Aneks të rrjetit të ujësjellsit në Lipjan, Silovi	Në Tenderim
17	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Krojmir, Kraisht dhe Asfaltimi i rrugës me Trotuar në fshatin Zllakuqan faza V	Në Tenderim
18	Ndërtimi i Urave në fshtarat Aklap, Janjev, Banull faza III	Në Tenderim
19	Ndërtimi i infrastrukturës së memorialit i UCK në fshatin Shalë	Në Tenderim

Lista e projekteve nga Departamentet tjera e që menaxhohen nga Departamenti për Infrastrukturë

1	Ndërtimi i qendrës urgjente në Qytetin e Lipjanit dhe QKMF	Në Implimentim
2	Ndërtimi i ulseve për shikues dhe vendosja e barit articial në fushat e hapura sportive në fshatrat Kraishtë, Ribar i Madh, Smallushë, Rufc, Gadime e Ulët, Silovi	Në Implimentim
3	Ndërtimi i Qendrës multifunkionale në qytetin e Lipjanit	Në Implimentim
4	Furnalimi dhe vendosja me bari sintetik dhe Infrastruktura tjetër në fushat sportive në Magure dhe Dobrajë të Madhe	Në Implimentim
5	Renovimi eficient i shkollave në Rufc të Ri, Topliqan, Janjevë, Qylagë, Medvec, Kojskë, Shalë Shkolla e Mesme	Në Implimentim
6	Renovimi i shkollave në Shalë (fillore) dhe Silovi	Në Implimentim
7	Ndërtimi i infrastrukturës në sallën e sporteve në Glllogovc dhe në Rufc të ri	Në Tenderim
8	Ndërtimi i infrastrukturës në oborrin e shkollës fillore në fshatin Ribar i Madh	Në Tenderim

Sektori i menaxhimit të projekteve përveq bashkëpunimit në detyrat projektuese, hartimin e projekteve, hartimit të paramasave dhe parallogarive, procedimit të lëndëve në procedura të publikimit, menaxhimit të projekteve në teren dhe pranimit përfundimtar të punimeve, ka kryer edhe punë të tjera në suaza të kompetencave në bashkëpunim edhe me departamentet tjera.

Në kuadër të aktiviteteve të departamentit, veçojmë angazhimin në kuadër të grupit të performancës, në komisione për vlerësimin e dëmeve, në komision për vlerësimin e tenderëve, në hartimin e rregulloreve dhe strategjive, etj.

Departamenti infrastrukturës ka ndërtuar sistemin elektronik të të dhënave të infrastrukturës në territorin e komunës tonë të cilat të dhëna përditësohen, vërsishte nga zhvillimi i ndërtimit të Infrastrukturës në teren.

DREJTORATI PËR INSPEKSION

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti kemi pasur një dinamizëm të inspektimeve në secilin sektor, është punuar sipas planit të punës, janë bërë organizime të shumta duke organizuar edhe kujdestari pas orarit të rregullt, vikendeve dhe festave zyrtare. Pjesë e agjendës së inspektoratit kanë qenë edhe ankesat nga qytetarët.

Inspektorët e tregut, kanë inspektuar në vazhdimësi subjekte të ndryshme afariste. Objektivi i inspektimit ka qenë regjistrimi i bizneseve, urdhëresat për pranim teknik, realizimi i pranimit teknik të lokaleve në të cilat realizohet veprimtari biznesore. Janë realizuar 63 pranime teknike të bizneseve që i plotësojnë kushtet për të ushtruar aktivitetin e tyre biznesor. Pjesë e agjendës së inspektorëve të tregut ka qenë inspektimi i marketeve. Është kontrolluar për çmimin e artikujve, përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë si dhe vendosjen e flamujve të cilët tregojnë origjinën e produktit.

Në bizneset të cilat kemi hasur parregullsi është iniciuar procedurë kundërvajtësve në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega Lipjan.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës njësisia në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" janë identifikuar dhe janë ndaluar disa persona të cilët ushtronin veprimtari ilegale brenda hapësirave të Aeroportit "Adem Jashari", veprimtari të dhënies me qira të veturave për qytetarët të cilët e frekuentonin Aeroportin.

Prioritare ka qenë ndalimi i shitjes jashtë tregut (nuk është lejuar asnjë lloj shitje jashtë tregut). Inspektim i vazhdueshëm është bërë në tregun gjelbër, kafshëve dhe mobileve.

Inspektori i ambientit. Në gjashtë mujorin e parë të vitit nga sektori i mjedisit-ambientit prioritet ka qenë shqyrtimi i kërkesave-ankesave me shkrimë të pranuar nga qytetarët si dhe ndëshkimi i të gjithë atyre që takohen duke ndotë ambientin. Kërkesat-ankesat e qytetarëve kryesisht kanë qenë për mbyllje të rrjetit të kanalizimeve, mbyllje të kanaleve për ujëra atmosferik, ankesa për zhurmë dhe pengesa tjera si pasojë e vendosjes ventilimeve, kondicionerëve nga biznese në muret e objekteve në bashkëpronësi, hedhje të mbeturinave dhe plehrave të stallave në prona private dhe publike. Për çdo ankesë të pranuar është konstatuar gjendja me procesverbal në teren, janë dhënë urdhëresa me afate të caktuara për mënjanimin e parregullsive, por edhe janë shqiptuar gjoba mandatore për hedhje të mbeturinave në prona publike, natyrë dhe lumenj.

Është realizuar inspektim në deponitë ilegale të mbeturinave në fshatrat Sllavi, Smallushë, Gadime e Ulët, dhe Epërme, Glllogovc. Shalë, Krojmir, Kodra e Kërçevës etj. Gjatë kontrollës janë gjetur edhe dëshmi (kuponë fiskal, materiale me mbishkrime të bizneseve etj) për mbeturinat e hedhur nga biznese në prona publike, ndaj tyre janë marrë masa duke ju shqiptuar gjobë mandatore dhe janë dhënë urdhëresë për largim nga vendi ku janë hedhur. Janë detyruar biznese të ndryshme që mbeturinat t'i dorëzojnë Kompanisë Pastrimi dhe kjo të dëshmohej me kontratë.

Në bazë të rregulloreve komunale të gjitha bizneset në qytet (kafiterit, restorantet, shitoret e ndryshme) që shfrytëzojnë hapësirën publike përpara lokaleve me tavolina dhe ulëse, me mallra të ndryshëm për shitje, janë urdhëruar dhe gjithashtu janë pajisur me pëlqim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për hapësirën në shfrytëzim.

Janë kontrolluar biznese, objektet shumë banesorë në ndërtim e sipër në lidhje me zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore Komunale gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre. Gjatë kontrollave tek disa investitorë janë gjetur parregullsi janë dhënë

urdhëresa që t'i grumbullojnë mbeturinat e shpërndara në vend punishte, t'i vendosin në kontejner i cili duhet të jetë prezentë deri në përfundim të ndërtimit.

Inspektoret e trafikut. Objektivë e inspektoreve gjatë këtij gjashtë mujori ka qenë secila parregullsi në trafik, pra me fokus është bërë inspektimi i kompanive të autobusëve, radio taksit, auto-taksive si dhe kombi-taksi ilegal.

Kompanitë e autobusëve janë inspektuar për licenca, çertifikata të autobusëve, rend të udhëtimit është bërë verifikimi i orarit të punës dhe janë urdhëruar firmat që të respektohet rendi i udhëtimit ashtu si është lëshuar nga organi kompetent. Janë ndaluar auto-taksi dhe kombi-taksi të cilët nuk kishin Licencë dhe janë përjashtuar nga komunikacioni në afat prej 5 ditësh (të cilëve i janë konfiskuar targat dhe librezat e qarkullimit), si dhe janë shqiptuar gjyba mandatore.

Janë organizuar kujdestari ku gjatë kujdestarisë janë bërë aksione në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në Lipjan, Magure edhe me Policinë kufitare në Aeroportin Ndërkombëtarë "Adem Jashari". Fokus ishin auto-taxit të cilët tentojnë të operojnë ilegalisht, radio taksit si dhe veprimtaria dhënie e veturave me qera (inspektime të realizuara në bashkëpunim me inspektorët e tregut).

Pjesë e inspektimeve kanë qenë rrugët në qytet dhe në fshatra, për secilën prerje, dëmtim janë marrë të gjithë hapat procedural ligjor.

Gjatë inspektimit, inspektorët e trafikut kanë realizuar procesverbale, gjyba mandatore si dhe janë konfiskuar targa dhe librezat e automjeteve me të cilat ushtrohej veprimtaria taksit pa licencë.

Inspektori i ndërtimit. Janë inspektuar në teren objektet të ndryshme ndërtimi përgjatë zonave urbanistike, si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.

Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal. Ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi janë realizu hapat procedural ligjor.

Pra, nga inspektorët e ndërtimit janë realizu, procesverbale, aktvendime për ndalim të punimeve, aktvendim për rrënim, aktvendim për vet rrënim, vendosje të shiritave, fletëparaqitje, gjyba mandatorë si dhe kallëzim penal.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjës në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në mënyrë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë gjashtë mujorit të parë janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste., si dhe janë bërë pranime teknike të lokaleve afariste. Janë inspektuar lokalet afariste, marketet ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet e arkës gjatë pagesës.

Është bërë inspektimi i tregjeve, ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Largimi i shitësve ambulat pa pëlqim në rrugët e qytetit.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë

Fletëparaqitje për kundërvajtje.

Janë shqiptuar gjyba mandatorë.

Aktvendime

Kallëzime penal.

Detyrimet e bizneseve ndaj komunës për shfrytëzimin e hapësirave publike (terasave) sipas rregulloreve Komunale.

Kontroll i bizneseve si investitor të objekteve ndërtimore me shumë njësi banimi në zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore Komunale.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë dhe sanimi i tyre sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej Inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime për objekte të legalizuara nga DPUMM-	Kontrolla për Leje Mjedisore komunale	Vendosje të shiritave	Njoftime për leje ndërtimore nga DPUMM-ja	Vërejtje, njoftime	Inspektim i raportit final	Njoftime për leje të refuzuara nga DPUMM-ja	Punë me palë, ankesa, kërkesa	Lendet e pranuar	Lende të pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Gjoha mandatore	Konfiskime –kthim i targave dhe tabelave	Kallëzime penale	Menaxhim i tregjeve	Aktivndime, ndalesa, urdhëresa	Njoftime për fillim të ndërtimeve	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim pa pranimitëknik
Biznesi	1041	147	63	13								421	94		2			69	94		31	107
Ambienti	225	88			23			4				56	34	1	7						12	
Ndërtimi	277	91	5		2 5		1 2	20	2	1	30		52	2	8		1		17	7	4	
Trafiku	388	76							14 5			57	6	3	5	14		48	7		27	
Gjithsej	1931	402	68	13	25	23	12	20	151	1	30	534	186	6	22	14	1	117	118	7	74	107

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike se a i plotësojnë kushtet për të ushtruar veprimtarin e tyre biznesore.

Inspektimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore përgjatë zonave urbanistike-ndërtuese dhe parandalimi i tyre duke ndërmarr masa ligjore.

Inspektimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet.

Mbrojtja e hapësirave gjelbëruese, ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegale në ANP.

DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSISË

Drejtorati për bujqësi dhe zhvillim rural ka mbajtur takime të rregullta mujore sipas nëvojave të drejtoratit. Duke u nisur nga fakti që çdo fillim vit është i paraparë të fillojë me planifikime për punën edhe aktivitetin që do të pasojnë gjatë gjithë vitit.

Si çdo fillim vitë, Drejtori, formon komisionin në kuader të Drejtoratit në periudhën një vjeçare, ky Komision do të monitoroj, vizitoj, përgadis raporte për kërkesat e bëra nga ana e fermerëve të cilët mund të kenë dëme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, kafshët e egra apo të tjera.

Gjithashtu, gjatë muajit Janar, kemi filluar procedurat për subvencionimin e fermerëve me mekanizëm bujqësorë të llojit frez për traktor, duke përgaditur edhe thirrjen publike e cila ka pasuar gjatë muajit shkurt dhe ka qenë e hapur për aplikim 15 ditë kalendrike, ku gjatë këtij aplikimi kanë aplikuar rreth 469 aplikues. Numri i pëefituesve do të jetë 273.

Po ashtu gjatë muajit Janar, kemi pranuar kërkesat e fermerëve të cilët aplikojnë për sasi të qumështit në Ministri të Bujqësisë.

Gjatë muajit Shkurt, kemi përgaditur thirrjen për të subvencionuar sektorin e blegtoris për liter të qumështit, për periudhën 6 mujorshe të vitit të kaluar korrik Dhjetor 2023, ku gjatë thirrjes kemi pasur rreth 50 aplikime. Duke parë si shumë të nevojshëm përkrahjen për këtë sektor, do të vazhdohet edhe periudhave të tjera gjatë vitëve.

Po ashtu, bashkëpunimi me organizatën IRK në projektin e serave ka filluar në muajin shkurt me vizitat në teren të komisionit të përbashkët në mes të Komunës dhe organizatës. Pas vizitave në teren do të bëhet përzgjedhja e 133 përfituesve, duke përfshi edhe 100 në listen pritëse të Komunës ku në total pritet të shpërndahen 233 sera të fermerët përfitues.

Sipas raportit të menaxherit për trajtimin e qenëve endacak ka vazhduar trajtimi i tyre sipas kërkesave të qytetarëve në lagje dhe fshatra, pavarësisht vështërsive, ne si drejtorat repsketivisht si Komunë jemi duke provuar të bejmë më të mirën ndaj kësaj problematike deri me tani janë trajtuar afërsisht mbi 550 qenë endacak dhe do të vazhdojë gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm.

Në bashkfinancim me organizatën e Qatar Charity, në projektin e hapjes së puseve për familjet të cilat kanë mungesë të ujit të pijëshëm dhe janë me kushte të dopta Ekonomike do të jenë prioritet. Në periudhën 6 mujorshe të vitit janë hapur mbi 50 puse për familjet në nevojë. Ky projekt pritet të vazhdojë deri në fund të vitit.

Gjatë muajit Marsë është bërë hapja për aplikim për pagesa direkte, drejtorati ka bërë të gjitha përgaditjet, procesi i digjitalizimit të parcelave ka shkuar jashtzakonisht mire, ku për 30 ditë pune kanë aplikuar rreth 1650 fermer, për rreth 9,500 ha.

Si kërkesë e nevojshme, drejtorati për bujqësi ka pranuar dy konsulet për të ndihmuar dhe vazhduar punët në drejtorat pa ndonjë vështërsi, me ndarjen e sektorit të pylltaris, sektor ky që është bartur përgjegjësia në nivelin qendror dhe si rezultat i ndarjes së stafit, ishte e nevojshme pranimi i dy konsulentëve.

Për veq procedurave që kemi filluar qysh në fillim vit, tash jemi në fazën e zhavorimit të rrugëve fushore për të përmirësuar infrastrukturen rrugore për fermerët tanë të cilët kultivojnë kultura të ndryshme bujqësore. Përmirësimi i rrugëve fushore ka për qëllim të lehtësojë dhe ofroj qasje më të lehtë të fermerëve në tokat e tyre bujqësore, përveç qasjejs, presim edhe rendimente më të mira nga sektori i bujqësisë.

Pas përfundimit të procesit të digjitalizimit të parcelave, kemi filluar me grumbullimin e të dhënave nga drejtorati bujqësisë për të parë sa hektar janë të mbjellur dhe cilat kultura bujqësore dominojnë me sipërfaqe në Komunën e Lipjanit,

Me anë të tabelave mund të shihni listat e përfituesve të subvencioneve si dhe të dhëna të tjera për sipërfaqen me të mbjellura në komunën e Lipjanit për vitin 2024.

Me anë të kësaj table paraqesim të dhënat e përfituesëve të subvencioneve nga Komuna e Lipjanit dhe donatorët

Nr.	Projekti	Numri I përfituesve
1	Sera në bashkfinancim me IRK	133
2	Sera nga Komuna	100
3	Mekanizëm bujqësor freza për traktor nga Komuna	273
4	Subvencionimi për liter qumështi nga Komuna	50

Me anë të kësaj tablele paraqesim të dhënat e sipërfaqës më të mbjellurave në Komunën e Lipjanit për vitin 2024, këto të dhëna janë nxjerrur nga programi i pagesave direkte.

Nr.	Kultura	Sipërfaqja për hektar
1	Grur	4,008.77
2	Misër	4,350.30
3	Elb	23.50
4	Tërshër	71.22
5	Kunguj	95.35
6	Speca	34.62
7	Patate	150.00
8	Domate	0.96
9	Hudhër	0.35
10	Qepë	79.82
11	Laker	6.52
12	Fasule	196.26
13	Shalqir	15.72
14	Kunguj Misiri	17.05
15	Perime në Serë	6.86
16	Thekër	2.00
17	Lule Dielli	1.00
18	Lulelakër	0.88
19	Pjepër	15.45
20	Mollë	47.10
21	Dardhë	2.4
22	Lejthi	14.65
23	Arrë	30.57
24	Kumbullë	24.51
25	Aronia	0.30
26	Dredhëz`	2.93
27	Mjedër	2.71
28	Qershi	2.28
29	Vreshtë	4.59
30	Kungulleshë	0.37
31	BMA	3.45
32	Marull	0.50
	Totali	9.285

Me anë të kësaj tablele tregojmë të dhënat për sektorin e belgtorisë dhe Bletarin në Komunën e Lipjanit për vitin 2024. Këto të dhëna janë nxjerrur nga programi i pagesave direkte.

Nr.	Kafshë	Totali
1	Lopë Qumështore	1,534
2	Mushqerra	153

3	Dele për mbarsim	2,896
4	Dhi për mbarësim	593
5	Koshere Bletësh	5,435
6	Pula	6,350

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të DSHPMSH -së gjatë periudhës së gjashtë mujorit (6) të parë të vitit 2024, DSHPMSH-ja ka kryer aktivitetet që ka pasur në plan për këtë periudhë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara gjatë kësaj periudhe.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Aktivitetet e përgjithshme të DSHPMSH gjatë 6 mujorit në mënyrë kronologjike

- Pranimi, evidentimi, arkivimi dhe zgjedhja e kërkesave të arritura nga qytetarët apo institucionet të tjera.
- Janë dhënë përgjigje kërkesave të parashtruara.
- Punimi i raporteve mujore dhe gjashtë mujor.
- Është punuar raporti i punës së DSHPMSH-së për vitin 2023, plani i punës së Drejtoratit për vitin 2024 dhe plani i prokurimit për vitin 2024.
- Janë mbajtur takime me qytetarë që kanë paraqitur kërkesa individuale dhe grupore nga përfaqësuesit e vendbanimeve të caktuara.
- Është bërë prezantimi në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve dhe Asamblesë Komunale.
- Është bërë kërkesë Kryetarit të Komunës për nxjerrjen e vendimit për shpalljen e njoftimit publik dhe formimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për Auto- Taxi.
- Kërkesa zyrës së Avokatit Komunal për vazhdimin e procedurave për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara në asetet komunale në rrugën "Bajram Gashi" në Lipjan, në fsh. Qylagë dhe Gadime e Ultë.
- Kërkesë Drejtoratit për Prokurim për iniciimin e procedurave të prokurimit: mirëmbajtja e rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe fshatra, pastrimi i varrezave dhe lapidarëve në komunën e Lipjanit, furnizimi me energji elektrike i ormanit të ndriqimit publik në shtigjet e ecjes në Sllovi, mirëmbajtja e shenjzimit horizontal dhe vertikal në komunën e Lipjanit, mirëmbajtja e paisjeve sinjalizuese, kamerave, zërimit dhe paisjeve tjera, furnizimi dhe montimi i shtyllave të betonarmisë dhe mirëmbajtja e ndriqimit publik në qytet dhe fshatra.
- Janë bërë kërkesa DBF-së për zotimet e mjeteve financiare për pagesat për borgjet e mbetura nga viti i kaluar të kontratave kornizë dhe pagesat tjera të këtij gjashtë mujori.
- Kërkesë Drejtoratit për Inspektorat për inspektim të bizneseve me qëllim të pajisjes me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe kërkesë për identifikimin e deponive ilegale.
- Kërkesa Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtoratit për Arsimit, Drejtoratit për Bujqësi dhe KRM Pasrtimit Njo Lipjan për ofrimin e të dhënave nga fushat e tyre për përfshirje në Planin për Menaxhimin e Mbeturinave.
- Janë bërë kërkesa KRU Prishtina NjOU Lipjan për deblokimin e rrjeteve të kanalizimeve sipas kërkesave të qytetarëve.
- Është bërë kërkesë Policisë së Kosovës – Njësia në Lipjan për vazhdimin e procedurave hetimore dhe kompenzimin për djegien e pushimores në shtigjet e ecjes në Lipjan.
- Është bërë kërkesë AME-së për dalje në teren për vlerësimin e sigurisë teknike të objektit në Rr."Skënderbeu" në Lipjan.
- Njoftim INFRAKOS Sh.A për shenjzim vertikal pranë vendkalimeve mbi hekurudhë.
- Është përgaditë dhe është shpallë njoftimi publik për ndarjen e licencave për operatorët auto taksit.
- Është bërë barazimi me KEDS-in i fakturave të ndriqimit publik.
- Është bërë barazimi i të hyrave nga inkasimi i mjeteve nga hapësirat publike si dhe i të hyrave nga tregjet.

- Është hartuar dhe miratuar Plani për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2024-2028, është hartuar dhe dërguar për procedurat e mëtutjeshme të miratimit në Asamblenë Komunale draft Plani për ndarjen e orareve të transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028 dhe plotësim ndryshimi i Rregullores për transportin e rregullit urban periferik në territorin e komunës së Lipjanit.
- Marrja pjesë në hapje dhe në vlerësim të tenderëve të shpallur nga Dejtora për Prokurimit.
- Janë dhënë pëlqime sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Janë dhënë Vendime për shfrytëzim të hapësirës publike para lokaleve afariste.
- Janë dhënë vërtetime për kryerjen e shërbimit ushtarak.
- Janë dhënë vërtetime për shtëpi të djegura gjatë luftës.
- Është bërë krasitja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit dhe në sheshin "Adem Jashari" dhe janë mbjellur lulet në rrethrotullime dhe në vazot e qytetit.
- Janë bërë intervenime në rrjetet e kanalizimit: në fsh. Dobrajë e Madhe, Medvec, Llugaxhi, Shalë, Gadime e Epërme, Grackë e Vogël, Bujan, Ribar i Madh, Gadime e Ulët, Hallaq i Vogël, Kraishtë, Qylagë, Rubofc, Rufc i Ri dhe në qytetin e Lipjanit.
- Janë bërë intervenime në rrjetin e ndriçimit publik, në ndërrimin e poqave dhe paisjeve tjera të prishura në vendbanimet: Grackë e Vjetër, Lagja Konjuhut, Banullë, Vërshvec, Magurë, Babush, Grackë e Vjetër, Banullë, Gadime e Ulët, Breg të Zi, Qallopek, Dobrajë e Madhe, Mirenë, Gllanicë, Ribar i Madh, Hallaq i Madh, Marevc dhe në qytetin e Lipjanit.
- Është bërë pastrimi, larja dhe rregullimi i permendoreve në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve për përvjetorin e përkujtimit.
- Është bërë pastrimi dhe largimi i mbeturinave – deponive ilegale nëpër disa fshatra.
- Janë menaxhuar kompanitë sipas loteve të ndara për pastrimin e borës në rrugët e qytetit dhe në fshatra.
- Menaxhimi i tregjeve në Komunën e Lipjanit.
- Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror.
- Pastrimi i varrezave dhe sanimi i lapidarëve në Komunën e Lipjanit.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjëve në Komunën e Lipjanit.
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe në fshatra.
- Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve të asfaltuara dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit.
- Mirëmbajtja e rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe në fshatra.
- Njësia profesionale e zjarrfikësve ka kryer aktivitetet dhe interevnimet në teren sipas kërkesave dhe informatave të marura nga qytetarët.

Aktivitetet e veçanta

- Ndër aktivitetet më të rëndësishme të DSHPMSh-së që karakterizojnë periudhën kohore të raportimit janë:
- Kërkesë QRA Lipjan për numrin e veturave të regjistruara gjatë vitit 2023.
- Janë plotësuar formularët me të dhëna për raportim për performancën komunale për vitin 2023.
- Janë plotësuar të dhënat nga fusha e DSHPMSh-së për raportin për përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane.
- Janë përgaditë të dhënat nga fusha e DSHPMSh-së për planin e Integritetit.

STATISTIKAT

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
359	287	//	26	46

Pasqyra e aktiviteteve të DSHPMSh-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr. i aktiviteteve

1	Kërkesa, përgjigje, njoftime, vendime, pëlqime te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	238
2	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive	6
3	Vizita në terren	364
4	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	5
5	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	11
6	Mbikëqyrja e kontratave kornizë	13

Njësia profesionale e zjarrfikësve ka kryer aktivitete dhe intervenime në terren sipas kërkesave dhe informatave të marrura nga qytetarët dhe jo vetëm.

Intervenimet e NJPZSh –së për periudhen Janar – Qershor 2024.

Nr.	Lloji i Interven/ muaji	Numri i intervenimeve
	Zjarre	85
1.	Shtëpi banimi/ oxhak	12
2.	Shtëpi ndihmëse	3
3.	Shtalla / Pleme *	3
4.	Locale/ obj. l vjetër shkollor	3
5.	Objekte afariste/ industriale*	3
6.	Male	15
7.	Ushqim bagëtish/ <i>grunajë*</i>	3
8.	Bari i thatë/ sternishtë	17
9.	Goma / Mazut *	//
10.	Mbeturina – Kontejnerë*	14
11.	Trafo /gjenerator */ngrohtor	//
12.	Orë rryme/ bomb.gazi*	3
13.	Instalime të rrymës	//
14.	Shtylla	1
15.	Automjete/ kamion*	4
16.	Dru teknik/ thëngjill*	1
	Intervenime Teknike	3
1.	Aksidente komunikacioni	3
2.	Automjete	1
3.	Hapje dyersh/ashensor*	//
4.	Rrënimë	1
5.	Terhaje automjetesh	//
6.	Thithje e ujit/ thyrje akulli*	//
7.	<i>Intervenime tjera teknike</i>	3
	Shërbime	13
1.	Furnizime me ujë	3
2.	Pastrim rrugësh/dezinfekt.	7
3.	Sigurime/ gara me automobila	3
4.	prerje-largim drunjësh	1
	Shpëtime	5
1.	Shpëtime nga lartësia	//
2.	Shpëtime nga uji	1
3.	Shpëtime në hekurudha	//
4.	Shpëtimime tjera	//
5.	Pjesëmarrje në xhirim filmi	//
6.	Ushtrim në Aeroport /me nxënës*	1
7.	Alarme të rreme për bombë	3
	Gjithsejt	110

DREJTORATI I PROKURIMIT

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në këtë Raport, janë të përfshira të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Lipjanit ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe gjashtëmujor, për gjitha kategoritë e shpenzimeve, furnizime, shërbime dhe punë, duke përcjellur planin e punës dhe planin e prokurimit, deri në periudhën raportuese realizimi i planit të prokurimit sillet rreth 50%.

Drejtorati i Prokurimit gjatë kësaj periudhe ka bashkëpunuar ngushtë me AQP-në, për të ofruar informata të nevojshme kur AQP-ja në planin e saj ka udhëheqjen e prokurimeve të centralizuara për nevoja të autoriteteve kontraktuese të nivelit lokal ose atij qendror, ashtu sikurse është rregulluar me dispozitat e nenit 94 dhe 95 të LPP-së. Po ashtu bashkëpunimi ka vazhduar edhe me organizatat e caktuara jo qeveritare mbi bazën e marrëveshjeve së bashkëpunimit e lidhur mes Komunës së Lipjanit, e cila në fokus ka bashkëpunimin, ofrimin e ndihmës dhe monitorimin e aktiviteteve të punës, me theks të veçantë trajnimin e stafit për kryerjen me sukses të aktiviteteve të punës, hapje tenderëve, vlerësim dhe menaxhim të kontratave dhe punë tjera të nevojshme.

Drejtoria e Prokurimit, ka një shkallë të lartë të përgjegjësisë për të siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike dhe menaxhimit sa më të mirë të fondeve publike.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë kësaj periudhe raportuese, shenojmë këto aktivitete të Prokurimit:

- Kemi dërguar Planin e Prokurimit në Autoritetin Qendror të Prokurimit, për vitin 2024.
- Kemi dërguar raportin në KRPP, rrespektivisht raportin e kontratave publike të nënshkruar për vitin fiskal 2023.
- Kemi punuar dhe dorëzuar Planin e Punës për vitin 2024, si dhe raportin e punës për vitin 2023, tek zyra e kryetarit.
- Kemi dërguar në drejtoratin për Buxhet dhe Financave listën e obligimeve për vitin 2023

Njoftim për Kontratë

Nr	Lloji i dokumentit	Vlera e parashikuar	Data e Publikimit	Data e Mbylljes
1	Furnizimi i çerdhes me materiale të imta shtrojë e mbulojë	9.500.00	21.01.2024	30.01.2024
3	Furnizim i çerdhes me pasjise shtëpiake dhe Klima	9.000.00	22.01.2024	29.01.2024
4	Riparimi i defekteve dhe rregullimi i kulmeve në Institucionet Edukativo Arsimore	45.000.00	16.01.2024	07.02.2024
5	Furnizimi me material për mirëmbajtjen të Objekteve në të gjitha IEA dhe institucionet tjera komunale	100.000.00	17.01.2024	07.02.2024
6	Instalimi i internetit dhe shërbimet e rregullta mujore për paralelet e ndara fizike te IEA	15.000.00	16.01.2024	06.02.2024
7	Furnizimi me artikuj te ndryshem per dite te shkollave	10.000.00	18.01.2024	09.02.2024
8	Furnizim me material higjenik	66.000.00	22.01.2024	12.02.2024
9	Mirembajtja dhe servisimi klimave	30.000.00	25.01.2024	16.02.2024
10	Mirëmbajtja e rrjeteve të Kanalizimit në qytet dhe fshatra	300.000.00	26.01.2024	20.02.2024
11	Furnizimi me mekanizëm bujqësor për fermer	300.000.00	24.01.2024	04.03.2024
12	Sigurimi i Automjeteve	33.800.00	30.01.2024	20.02.2024

13	Shtruarja e rrugëve fushore me zhavor	520.000.00	25.01.2024	19.03.2024
14	Sigurimi fizik i objekteve në shkollat SHFMU Vëllezërit Frashëri, SHMP Adem Gllavica dhe Gjimnazi Ulpiana Lipjan	40.000.00	08.02.2024	05.03.2024
15	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit për shtëpinë me bazë në komunitet	14.400.00	15.02.2024	08.03.2024
16	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit & asflltimit i rrugicave në Kleqkë	139.000	15.02.2024	11.03.2024
17	Furnizimi me energji elektrike i ormanit të ndriçimit publik në shtigjet e ecjes në Sillovi	9.900.00	26.02.2024	04.03.2024
18	Demolimi furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve ne disa IEA-ritenderim	40.000.00	29.02.2024	22.03.2024
19	Shërbime konsulente për nevojat e Komunës së Lipjanit , 2 llot	26.400.00	28.02.2024	21.03.2024
20	Riparimi i defekteve dhe rregullimi i kulmeve në Institucionet Edukativo Arsimore	45.000.00	16.01.2024	07.02.2024
21	Furnizimi me material për mirëmbajtjen të Objekteve në të gjitha IEA dhe institucionet tjera komunale	100.000.00	17.01.2024	07.02.2024
22	Furnizim i Cerdhes ne Rufe te Ri me invertar-Ritender	17.000.00	07.02.2024	27.02.2024
23	Pastrimi i varrezave dhe lapidarëve në Komunën e Lipjanit	200.000.00	11.03.2024	02.04.2024
24	Furnizimi me barna dhe materiale tjera mjekësore në QKMF	160.000.00	21.03.2024	27.04.2024
25	Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit	100.000.00	20.03.2024	12.04.2024
26	Transporti i nxënësve semimaturant në testin e arritshmëris	2.200.00	25.03.2024	02.04.2024
27	Mirëmbajtja e paisjeve sinjaluese, kamerave, zërimit dhe paisjeve tjera.	115.000.00	21.03.2024	11.04.2024
28	Asgjësimi i materialeve të mprehta dhe jo të mprehta medicinale në QKMF,QKF dhe AMF - Kontratë 3 vjeqare	40.000.00	27.03.2024	16.04.2024
29	Furnizimi me foli dhe rolle printeri për Autokilav në QKMF, QMF dhe AMF-Ritenderim	5.000.00	26.03.2024	03.04.2024
30	Furnizimi me instrumente dhe paisje medicinale në QKMF,QKM dhe AMF	10.000.00	27.03.2024	05.04.2024
31	Furnizim me inventar për institucionet shendetesore	6.000.00	28.03.2024	05.04.2024
32	Furnizimi me energji elektrike i ormanit të ndriçimit publik në shtigjet e ecjes në Sillovi	9.900.00	26.02.2024	04.03.2024
33	Qëndrim javor në vendet turistike për banorët e shtëpise me bazë në Komunitet	9.900.00	20.03.2024	27.03.2024
34	Dislokimi dhe furnizimi i shtyllave elektrike në rrugën Bashkim Krasniqi në Lipjan	3.000.00	21.03.2024	27.03.2024
35	Furnizimi dhe montimi me pano reklamuese dhe tabel dixhitale	9.500.00	05.03.2024	13.03.2024
36	Mbushja dhe servisim të bombolave kundër zjarrit	5.000.00	11.03.2024	18.03.2024
37	Furnizimi me pjesë dhe servisim i gjeneratorëve të institucioneve të Komunës së Lipjanit	15.000.00	15.04.2024	07.05.2024
38	Furnizimi dhe montimi i xhamave në të gjitha IEA-të	20.000.00	08.04.2024	02.05.2024
39	Hartimi i planit lokal të veprimit në Mjedis (PLVM) për periudhen 2024-2029	9.700.00	11.04.2024	29.04.2024
40	Furnizimi me pelet për ngrohje për IEA-të dhe QKMF-në dhe DKRS-në	124.800.00	18.04.2024	28.05.2024
41	Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2029	20.000.00	17.04.2024	08.05.2024

42	Furnizimi me barna dhe materiale tjera mjekësore në QKMF	160.000.00	21.03.2024	27.04.2024
43	Transporti i nxënësve semimaturant në testin e arritshmëris	2.200.00	25.03.2024	02.04.2024
44	Llot 1 Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Krojmir, Kraishtë dhe asfaltimi i rrugës me trotuar në fshatin Zllakuqan - faza V. Llot 2 Rikonstruimi i rrugës së shkollës në Dobrajë të Madhe dhe rrugica tjera	480.000.00	22.05.2024	13.06.2024
45	Ndërtimi i urave në fshatrat Akllap, Janjevë dhe Banullë (faza III)	42.000.00	16.05.2024	05.06.2024
46	Izolimi dhe ngjyrosja e shkollës në Bujan	10.500.00	16.05.2024	05.06.2024
47	Dezinfektim,dezinfektim, dezinfektim për Institucionet Edukativo Arsimore dhe institucionet e tjera komunale	14.300.00	03.05.2024	03.06.2024
48	Ndërtimi i infrastruktures se sallat e sportive ne Gllgovc dhe Rufc te Ri	115.000.00	17.05.2024	10.06.2024
49	Ndërtimi i infrastruktures ne oborin e shkolles fillore ne fshatin Ribar i Madh	84.000.00	24.05.2024	14.06.2024
50	Gletimi dhe ngjyrosja në IEA në shkollën e Slllovisë dhe Qylagës	14.000.00	20.05.2024	10.06.2024
52	Furnizimi dhe montimi me kallda për ngrohje në QKMF, QMF dhe AMF	6.000.00	13.05.2024	21.05.2024
53	Rregullimi i parketit në shkollën e fshatit Topliqan, etj	9.500.00	21.05.2024	31.05.2024
54	Pajisje për sherbimet e zjarrfikësve	2.700.00	23.05.2024	29.05.2024
55	Ndërtimi i qendrës Multifunkionale në qytetin e Lipjanit	2.700.000.00€	20.06.2024	15.07.2026
56	Furnizim me veshëmbathje, çarçaf shumëpërdorimësh, njëpërdorimësh dhe uniforma në QKMF dhe Urgjencë	15.000.00€	14.06.2024	08.07.2024
57	Ndërtimi i infrastrukturës te memoriali i UÇK-së në fshatin Shalë	25.000.00€	13.06.2024	05.07.2024
58	Furnizimi dhe montimi i shtyllave të betonarmisë	5.500.00€	04.06.2024	13.06.2024
59	Aneks kontratë - Furnizimi me mekanizëm bujqësor për fermer	16.997.00	26.06.2024	01.07.2024
60	Demolimi i objektit të shkollës Adem Gilavica dhe shkollës në Resinovc	25.000.00	03.06.2024	24.06.2024

Njoftim për nënshkrim të Kontratës

Nr	Lënda e prokurimit	Vlera e kontratës	Data e Nënshkrimit
1	Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e objektit me shumë njësi banesore për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, si dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e objektit me shumë njësi banesore në qendren e qytetit në pjesen lindore të rrugës Lidhja e Prizerenit-Ritender	45.500.00€	10.01.2024
2	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve sportiv (kompleksi sportiv Better Life dhe palestra e re sportive)	55.600.00€	15.01.2024
3	Mbajtja e punëtorisë një ditore, lidhur me përgaditjen e cash planit për vitin 2024.	960.00€	18.01.2024
4	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime	6.665.00€	12.01.2024
5	Furnizimi i çerdhes me materiale të imta shtrojë e mbulojë	9.495.10€	12.02.2024
6	Furnizim i çerdhes me pasjise shtëpiake dhe Klima	7.396.30€	08.02.2024
7	Instalimi i internetit dhe shërbimet e rregullta mujore për paralelet e ndara fizike te IEA	6.330.72€	22.02.2024
9	Furnizimi me artikuj te ndryshem per dite te shkollave	10.000.00€	29.02.2024
10	Transporti i nxënësve në garat ndërkombëtare në Tiranë	918.50€	08.02.2024
11	Furnizimi me material për mirëmbajtjen të Objekteve në të gjitha IEA dhe institucionet tjera komunale	100.000.00€	29.02.2024

12	Riparimi i defekteve dhe rregullimi i kulmeve në Institucionet Edukativo Arsimore	45.000.00€	07.03.2024
13	Furnizim me material higjenik IEA dhe DKRS	66.000.00€	28.03.2024
14	Mirëmbajtja dhe servisimi klimave	30.000.00€	07.03.2024
15	Mirëmbajtja e rrjeteve të Kanalizimit në qytet dhe fshatra	300.000.00€	04.03.2024
16	Sigurimi i Automjeteve	34.119.10	29.03.2024
17	Furnizim i Çerdhes ne Rufe te Ri me inventar-Ritender	15.275.00€	21.03.2024
18	Furnizimi me mekanizëm bujqësor për fermer	184.750.00€	22.03.2024
19	Sigurimi fizik i objekteve në shkollat SHFMU Vëllezërit Frashëri, SHMP Adem Gllavica dhe Gjymnazi Ulpiana - Lipjan	39.645.90€	22.03.2024
20	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit & asflltimit i rrugicave në Kleqkë	137.819.98€	28.03.2024
21	Shtuarja e rrugëve fushore me zhavor	520.000.00€	26.04.2024
22	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit për shtëpinë me bazë në komunitet	11.880.00€	08.04.2024
23	Furnizimi me energji elektrike i ormanit të ndriçimit publik në shtigjet e ecjes në Sllavi	6.230.00€	29.03.2024
24	Shërbime konsulente për nevojat e Komunës së Lipjanit , 2 llot	26.000.00€	26.04.2024
25	Qëndrim javor në vendet turistike për banorët e shtëpise me bazë në Komunitet	9.618.00€	08.04.2024
26	Mbushja dhe servisim të bombolave kundër zjarrit	1.056.00€	08.04.2024
27	Furnizimi me foli dhe rollne printeri për Autokllav në QKMF, QMF dhe AMF-Ritenderim	5.000.00€	29.04.2024
28	Furnizimi me barna dhe materiale tjera mjekësore në QKMF	139.767.00	27.05.2024
29	Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit	100.000.00€	28.04.2024
30	Transporti i nxënësve semimaturant në testin e arritshmëris	2.184.99	02.05.2024
31	Demolimi furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve në disa IEA-ritenderim	40.000.00€	03.05.2024
32	Mirëmbajtja e paisjeve sinjaliuese, kamerave, zërimit dhe paisjeve tjera.	115.000.00€	16.05.2024
33	Asgjësimi i materialeve të mprehta dhe jo të mprehta medicinale në QKMF, QKF dhe AMF - Kontratë 3 vjeqare	40.000.00€	15.05.2024
34	Furnizimi me instrumente dhe paisje medicinale në QKMF, QKM dhe AMF	100.000.00€	20.05.2024
35	Furnizimi dhe montimi me pano reklamuese dhe tabel dixhitale	7.940.00€	02.05.2024
36	Furnizim me inventar për institucionet shëndetësore	5.475.00€	17.05.2024
37	Aneks kontratë-Asfaltimi i rrugës së Shkupit dhe rrugës së lumit në Gadime të Ulët faza II	10.088.75€	27.05.2024
38	Rregullimi i parketit në shkollën e fshatit Topliqan, etj	5.633.33€	27.06.2024
39	Pastrimi i varrezave dhe lapidarëve në Komunën e Lipjanit-Ritender	200.000.00€	07.06.2024
40	Furnizimi dhe montimi me kallda për ngrohje në QKMF, QMF dhe AMF	2.813.60€	21.06.2024
41	Furnizimi dhe montimi i xhamave në të gjitha IEA-të	16.900.00€	05.06.2024
42	Furnizimi me pjesë dhe servisimi i gjeneratorëve të institucioneve të Komunës së Lipjanit	4.316.00€	31.05.2024
43	Furnizimi dhe vendosja me barë sintetike dhe infrastruktura tjera ne fushat sportive ne Magure dhe Dobraje e madhe	1.198.386.50€	07.06.2024

ANKANDE PUBLIKE

- Shitja e aseteve jashtë përdorimit në pronësi të komunës , në objektin e Qendrës Kulturore “Tahir Sinani” në Lipjan.
- Shitja e prodhimeve bimore, Grurit.

Komunikimet me AQP-ne,

Komunikimet me Auditorin e Jashtëm: Kemi qenë gjatë gjithë kohës duke bashkëpunuar me auditoret, gjatë kohës së kanë qenë në auditim.

Kemi shkëputur kontratën me titullin:

1. Llot 2-Sigurimi fizik i objekteve të Institucioneve IEA, dhe
2. Furnizimi dhe montimi me pano reklamuese dhe tabel dixhitale.

Sfidat

* Funksionimi i ngadalshëm i bordit të Organi Shqyrtues i Prokurimi (OSHP), ka sjellur pasoja në mos lidhjen e dy kontratave duke pritur vendime e tyre, gjithashtu kërkesat për Ri-shqyrtim nga OE në vlerësimi të ofertave nga Drejtoria e Prokurimit.